



# RAPORT VJETOR 2023

**Kërko Dokumentet e publikuara**

Numrin e prokurimit	Autoriteti kontraktues	Numri i publikimit	Lloji i dokumentit	Lënda e prokurimit / grupi	FPP	FPP - Peshkrimi	Lloji i kontratës	Vlera e kontratës	Procedura
70433736-24-2854-2-3-6	KOMPANIA UJESJELLËSI RAJONAL PRISHTINA S.H.A.	2024/70433736-24-2854-2-3-6/B05-0007239	B05 Njoftim për Kontratë	Kalibrimi i pajisjeve matëse laboratorike	33000000-0	Pajisje mjekësore dhe laboratorike, pajisje optike dhe përcjellës, shtatë dhe orë, farmaceutike dhe konsumare mjekësore të ngjashme	2 Shërbime	Vlerë e ulët, Kuotim të Qëndrueshëm	6 Kuotim i Qëndrueshëm
124000-24-3027-2-3-6	AGJENCIA E STATISTIKAVE TE KOSOVES	2024/124000-24-3027-2-3-6/B05-0007241	B05 Njoftim për Kontratë	"Zgjerimi i rrjetit LAN dhe elektrik"	93000000-5	Shërbime të ndryshme	2 Shërbime	Vlerë e ulët, Kuotim të Qëndrueshëm	6 Kuotim i Qëndrueshëm
616-24-2585-2-2-1	KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES	2024/616-24-2585-2-2-1/B54-0007243	B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara	Transporti i rënësisë dhe asistencës për nevojat e Komunës së Prishtinës; Lëndët e prokurimit - Transporti i rënësisë dhe asistencës për nevojat e Komunës së Prishtinës, Prishtinë -Kaçanik dhe anasjelltas, Prishtinë-Lajçë dhe anasjelltas, Prishtinë-Lajçë dhe anasjelltas, Prishtinë-Komuna - Teshik-Rrethi i apëllat-Hajval-Kahriçe-Sulejke-Mramuar, Lajçë-Cesula-Shkollë-Kaçanik dhe anasjelltas, Prishtinë- Vranocoll-Terandoll-Sharban dhe anasjelltas, Prishtinë-Sarçosh-Bairice e Posthime dhe anasjelltas	93000000-8	Shërbime të ndryshme	2 Shërbime	2 Vlerë e mesme	1 Procedura e hapur
652-24-2834-1-4-7	KUVENDI I KOMUNES - KACANIK	2024/652-24-2834-1-4-7/B52-0007244	B52 Njoftimi për nënshkrimin e kontratës	Furnizimi me tonera për Administratën	93000000-8	Shërbime të ndryshme	1 Furnizim	4 Vlerë minimale	



**PERMBAJTJA**

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
2. KORNIZA LIGJORE .....	7
2.1 Baza ekzistuese ligjore që rregullon Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik .....	7
2.2.Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese .....	7
2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet .....	7
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT .....	8
3.1 Misioni/Vizioni .....	8
3.2.KOMPETENCAT E KRPP-SË .....	8
4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI.....	10
4.1 PARIMET THEMELORE TE FUNKSIONIMIT .....	10
4.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE E KRPP-SË .....	11
4.3 BORDI I KRPP-SË.....	12
4.4 DEPARTAMENTET DHE DIVIZIONET E KRPP-SË.....	17
5. AKTIVITETET E KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK .....	24
5.1 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË RREGULLAVE .....	24
5.2 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË MONITORIMIT.....	31
5.3 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË TRAJNIMEVE DHE INTEGRIMEVE .....	38
5.4 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK.....	45
5.5 AKTIVITETET E BASHKËPUNIMIT DHE PÛRKRAHJES NGA DONATORËT .....	48

6. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KRPP-SË.....	50
7. RAPORTI VJETOR FINANCIAR.....	53
8. ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	78
9. KONTRATAT E NËNSHKRUARA – STATISTIKAT .....	79
NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2023.....	80
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2023 .....	81
NUMRI TOTAL DHE VLERA FINANCIARE E KONTRATAVE VJETORE MBI PRAGJET FINANCIARE TË BE-së GJATË VITIT 2023 .....	83
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2023 SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT .....	84
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2023 SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT	88
KONTRATAT E NËNSHKRUARA DHE ANEKS-KONTRATAT GJATË VITIT 2023.....	92
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDORË DHE JO-VENDORË .....	93
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR PËR PUBLIKIM GJATË VITIT 2023 ...	94
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE KONTRATE GJATË VITIT 2023 .....	95
NUMRI MESATAR I OFERTUESVE QË KANË KONKURUAR PËR NJË TENDER GJATË VITIT 2023.....	96
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITEVE 2018-2023.....	96
NUMRI DHE VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË KOSOVË NGA AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2023 .....	97
KONTRATAT E NËNSHKRUARA ME VLERË MBI 2,000,000.00€ NGA AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2023 .....	102
SHTOJCA I - STATISTIKË DHE ANALIZË E TË DHËNAVE MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT TE ZHVILLUARA GJATË VITIT 2023 .....	106
SHTOJCA II - REALIZIMI I PLANIT TË PËRFORMANCËS 2023 .....	123

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ( në vijim “KRPP”) në përputhje me Nenin 87.2.13 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (tash e tutje “LPP”), çdo vit kalendarik përgatitë dhe dorëzon në Qeveri dhe Kuvend Raportin vjetor. Raporti vjetor, analizon aktivitetet e prokurimit publik të organizatave buxhetore në Republikën e Kosovës, brenda vitit kalendarik, poashtu, përfshinë rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e legjislacionit në fushën e prokurimit publik.

Bazuar në LPP dhe Ligjit Nr.06/1 -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, KRPP ka përgaditur këtë raport vjetor për periudhën kohore 01 janar – 31 dhjetor 2023, i cili përmbanë të dhëna dhe informacione si vijon:

- Korniza ligjore që rregullon funksionimin e institucionit;
- Organizimin institucional të KRPP-së;
- Fushëveprimtarinë e institucionit;
- Aktivitetet e KRPP-së për periudhën raportuese;
- Rekomandimet/sfidat e institucionit;
- Raportimin financiar;
- Raportin rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Kombëtare të Auditorit, dhe
- Raportin statistikor të kontratave publike të nënshkruara në sektorin publik për vitin 2023.

Pjesë përbërëse e këtij raporti është gjithashtu edhe Raporti i Performancës i cili përmbanë të dhëna mbi përmbushjen e Planit të Performancës për vitin 2023, duke përfshirë objektivat dhe aktivitetet kryesore të cilat KRPP i ka realizuar gjatë vitit 2023. Gjithashtu, ky raport përmbanë edhe një raport statistikor mbi të dhënat dhe procedurat e prokurimit publik, të zhvilluara gjatë vitit 2023.

Raporti, krahas përshkrimit të mandatit ligjor të institucionit, organizimit institucional dhe fushëveprimit, si pjesë kryesore do të përmbajë edhe aktivitetet dhe veprimet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik gjatë periudhës raportuese, të cilat aktivitete dhe veprime kanë si qëllim kryesor garantimin e mirë funksionimit të sistemit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, duke u fokusuar sidomos në çështjet si vijon:

- Avancimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor të prokurimit publik;
- Monitorimin e vazhdueshëm të procedurave të prokurimit, të zhvilluara nga autoritetet kontraktuese;
- Zhvillimin dhe avancimin e vazhdueshëm të prokurimit elektronik;
- Ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit publik, përmes organizimit të trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm;
- Dhënia e asistencës së vazhdueshme për Autoritetet Kontraktuese me qëllim të rritjes së efikasitetit në fushën e prokurimit publik;
- Rritjen e nivelit të transparencës në komunikim me publikun, bashkëpunimit ndërinstucional dhe shoqërinë civile.

Progresi dhe rezultatet e arritura nga aktivitetet e KRPP-së gjatë vitit 2023, do të paraqiten në kapitujt përkatës të këtij raporti.

Në përgjithësi, mund të nënvizohet progresi lidhur me rrezultatet e arritura derisa shkurtime dhe me përgjegjësi të plotë mund të konstatohet që progresi dhe rezultatet pozitive të arritura, të cilat janë në pajtueshmëri me planin dhe mandatin ligjor.

**Të arriturat kryesore të KRPP-së** si institucion i pavarur, si dhe të arriturat sa i përket prokurimit publik në Republikën e Kosovës, janë listuar si vijon:

- Përditësimi i legjislacionit dytësor në fushën e prokurimit publik përmes publikimit të dokumentave si: **Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, Manualin për Autoritete Kontraktuese në përdorimin e TEMF, Udhëzimin për Hulumtimin e tregut, Manual përdorimi për Autoritetet Kontraktuese – Kërkesat për rishqyrtim dhe ankesat**, 15 Interpretimeve dhe 5 Opinioneve në fushën e prokurimit publik, për të ndihmuar AK-se dhe OE në zbatimin praktik të legjislacionit aktual në prokurimin publik.
- Nxjerrja dhe aplikimi i **Metodologjisë së re për monitorim të aktiviteteve të prokurimit**, bazuar në lista harmonizuese – kontrolluese, duke ofruar mundësinë e ndryshimit të qasjes në aktivitete të monitorimit dhe rritjen e efikasitetit dhe përmbajtjes së aktiviteteve të monitorimit nga KRPP;
- **Funksionalizimi i Divizionit të Analizës dhe Statistikave** duke plotësuar vendin e lirë të punës, përkufizimin e 27 treguesve kyç (KPI) të performancës në prokurim publik, krijimi i veglës automatike (dashboard) konform këtyre treguesve për krijimin e raporteve të bazuara në të dhënat nga sistemi elektronik i prokurimit me qëllim të ofrimit të informatave në kohë reale, për të vlerësuar ndryshimet e politikave dhe marrjen e vendimeve bazuar në evidencën përkatëse;
- Sigurimi konsistent i ofrimit të shërbimeve nëpërmjet **Sistemit të Prokurimit Elektronik**, përmes të cilit rreth **165** Autoritete Kontraktuese kanë zhvilluar **12,397** aktivitete të prokurimit dhe kanë nënshkruar **10,083** kontrata në vlerë prej **810,438,403.40 €**, apo rreth **251,420,490.00 €** më shumë se në vitin paraprak.
- Monitorimi i rreth **9,300** njoftimeve dhe dokumenteve përkatëse nga procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktuese, nëpërmjet të cilit monitorim është intervenuar me rastin e evidentimit të moszbatimit të drejtë të parimeve bazë të prokurimit publik, si dhe janë evidentuar gjetjet dhe dobësitë për t'u adresuar dhe përmirësuar nga aspekti rregullativ i prokurimit publik.
- Avancimi i kapaciteteve profesionale dhe organizimi i trajnimeve për **812** zyrtarë nga Autoritetet Kontraktuese, prej të cilëve **136** zyrtarë janë trajnuar për kriterin **TEMF**, **426** zyrtarë të trajnuar për Menaxhimin e Kontratave, **124** zyrtarë të trajnuar sipas Marrëveshjeve

të bashkëpunimit me institucionet, si dhe **22** zyrtarë të trajnuar mbi Praktikën e hulumtimit e tregut.

- Rritja e dukshme e vlerës totale të kontratave të nënshkruara duke përdorur kriterin e dhënies **“Tenderi me çmimin ekonomikisht më të favorshëm”** në krahasim me kriterin e dhënies **“Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë”**. Gjatë vitit 2023 vlera totale e kontratave me përdorim të kriterit të dhënies **“Tenderi me çmimin ekonomikisht më të favorshëm”** ka arritur në **114,973,518.00€** ose rreth **14.19%** të të totalit të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2023; apo për rreth **9%** më shumë se sa në vitin paraprak.
- **Vlerësim i progresit në organizimin e trajnimeve** në fushën e prokurimit publik nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, paraqitur në **“Raportin për Kosovën të publikuar nga KE, për vitin 2022”**
- **Organizimi i takimeve të rregullta** të institucioneve kyçe me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional në fushën e Prokurimit Publik. Si rezultat, është finalizuar **Protokolli i Bashkëpunimit**, i cili përcakton qëllimin, parimet dhe objektivat e bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve kyçe relevante të prokurimit publik, për adresimin efektiv të sfidave në fushën e prokurimit publik në Kosovë;
- **Bashkëpunimin dhe nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit** me Policinë e Kosovës për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në fushën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.
- **Pjesëmarrje aktive** në tryeza, konferenca, media dhe aktivitete tjera me qëllim të rritjes së bashkëpunimit, transparencës institucionale dhe llogaridhënjes me Komunitetin e Biznesit, KSHC, OJQ-të, Partnerët vendor e ndërkombëtarë, si dhe publikun.
- Realizimi i procesit të auditimit të teknologjisë së informacionit **“Sistemi elektronik E-prokurimi”**, proces i cili është realizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit në periudhën maj-qershor 2023, dhe i cili ka rezultuar me një raport të auditimit mbi analizën, të gjeturat dhe rekomandimet.
- Avancimi i platformës së prokurimit elektronik me funksionet e reja lidhur me sistemin e ankimimit apo me operimin me **“Kërkesat për rishqyrtim”** dhe **“Ankesat”** - të cilat funksione të reja janë vënë në funksion nga data 24.01.2023.
- Publikimi i të dhënave të prokurimit sipas standardit të të dhënave të hapura, me qëllim të rritjes së transparencës dhe përdorimit të të dhënave të prokurimit publik, nga të gjitha palët.

## 2. KORNIZA LIGJORE

### 2.1 Baza ekzistuese ligjore që rregullon Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) është themeluar në bazë të Pjesës VI të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Sipas nenit 86 të këtij ligji, KRPP-ja është agjenci e pavarur rregullative dhe sipas nenit 87 të këtij ligji është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.

Përveç ligjit bazë Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik me të cilin është themeluar dhe janë rregulluar funksionet e institucionit, KRPP ka të nxjerrur the publikuar edhe dy rregullore që rregullojnë organizimin e brendshëm dhe punën e KRPP-së:

- *Rregullore Nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik; dhe*
- *Rregullore e Punës e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik*

Gjithashtu, me qëllim të zbatimit të LPP, KRPP ka mandat që të vendosë rregulla të hollësishme të prokurimit të cilat janë pjesë përbërëse e legjislacionit dytësor për prokurim publik.

### 2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Në periudhën raportuese KRPP ka ndërmarrë veprime kryesisht në përmirësimin e bazës ligjore që ka të bëjë me legjislacionin dytësor, manuale, udhëzues, etj.

Nga aktet më të rëndësishme të legjislacionit dytësorë, KRPP ka të nxjerrur:

- *Udhëzues Nr-001/2023 për prokurimin publik;*
- *Manual për përdorimin e kriterit “Tenderi Ekonomikisht më Favorshëm”;*
- *Udhëzim për Hulumtimin e tregut; dhe*
- *Manual përdorimi për Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik– Kërkesat për rishqyrtim dhe ankesat.*

, të cilat kanë për qëllim të plotësojë dhe pasurojnë aktet dytësore në dispozicion për të gjitha autoritetet kontraktues, operatorët ekonomik dhe palët e interesuara të përfshira në prokurim publik.

### 2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet

Edhe në vitin 2023 për KRPP-në mbeten pothuajse vështirësitë e njejta si në vitin paraprak. Nga vështirësitë ligjore që KRPP ka hasur në përmbushjen e misionit mbetet ende miratimi i ligjit të ri për prokurim publik, i cili edhe gjatë periudhës së raportimit ende qëndron në fazën finale të draftimit. Kjo për faktin se nëpërmjet ligjit të ri synohet që të adresohen dhe eliminohen të gjitha mangësitë e ligjit aktual, dhe sidomos pjesa që ka të bëjë me përshtatjen e legjislacionit parësorë me prokurimet elektronike. Njëjtë si në vitet paraprake edhe gjatë vitit 2023 mungesat dhe vështirësitë ligjore në këtë aspekt, KRPP i ka mbuluar nëpërmjet legjislacionit dytësor.



### 3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

#### 3.1 Misioni/Vizioni

Misioni i KRPP-së është zhvillimi funksionimi dhe mbikqyrja e përgjithshme e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e sistemit elektronik të prokurimit publik në Kosovë (E-Prokurimi).

Si rrjedhojë, misioni i KRPP-së është të nxis respektimin e parimeve themelore të prokurimit lidhur me transparencën, llogaridhënien, konkurrencën e ndershme, trajtim të barabartë dhe vlerën për para duke përmirësuar kapacitetin e sistemit të prokurimit përmes:

- Avancimit të sistemit të monitorimit për zbatimin të kornizës ligjore të prokurimit publik
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, trajnimi dhe arsimi;
- Avancimi i procedurave të menaxhimit të prokurimit publik;
- Rrjedhë më të mirë të komunikimit në mes të të gjithë akterëve të prokurimit publik;
- Prezantimin e objektivave socio-ekonomike dhe mjedisore, në kuadër të politikave të gjelbërta dhe të përgjegjshme shoqërore të prokurimit publik;
- Shfrytëzimit të metodave të reja bashkëkohore në zbatimin e ligjit të prokurimit publik si: prokurimit elektronik dhe prokurimi i centralizuar;si dhe
- Ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për funksionimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

#### 3.2.Kompetencat e KRPP-së

KRPP-së bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik, neni 87, ka kompetencat si në vijim:

- të përditësoj legjislacionin dytësorë duke vendosur rregulla të hollësishme dhe në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-se për prokurim për të siguruar zbatimin adekuat të Ligjit për Prokurimin Publik nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilën nga procedurat e përcaktuara në LPP
- të ofroj opinione për autoritete kontraktuese në lidhje me vendimet e tyre, veprat apo anashkalimet gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave
- të kryej monitorimet e aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave për qëllim të monitorimit të zbatimit të LPP
- të përgatisë dhe shpërndajë doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas LPP në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- të përforcojë vetëdijen në mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e tij
- t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik



- për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- të nxjerrë dhe publikojë interpretime me shkrim të vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të LPP dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
  - të krijojë dhe të mirëmbajë një Regjistër elektronik të Prokurimit Publik që shërben si vend për ruajtjen e kopjeve elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara ose të nxjerra në lidhje me çdo aktivitet prokurimi të kryer ose të iniciuar nga një autoritet kontraktues;
  - të krijojë sisteme manuale dhe elektronike për monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga ana e autoriteteve kontraktuese, duke përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që duhet të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese subjekte të këtij ligji;
  - të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat publike të dhëna;
  - për çdo vit kalendarik të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e LPP, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të marsit të vitit vijues kalendarik;
  - të krijojë dhe mirëmbajë një webfaqe informative në internet që i ofron publikut qasje të pa kufizuar në (i) këtë ligj dhe gjithë legjislacionin sekondar të nxjerrë sipas këtij ligji, (ii) interpretimet dhe dokumentet e përcaktuara në këtë nen dhe (iii) të gjitha informacionet që përmbahen në Regjistrin e Prokurimit Publik;
  - të zhvillojë një webfaqe dhe një sistem elektronik informativ në mbarë Kosovën për të përmirësuar publikimin e njoftimeve të kërkuara nga ky ligj;
  - të mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik, ankandit elektronik dhe komunikimit brenda fushës së prokurimit publik;
  - të përgatisë dhe mbajë një listë të autoriteteve kontraktuese që i identifikon të gjitha entitetet që janë subjekt i këtij ligji, me kusht që nëse KRPP-ja nuk e përfshin një entitet në këtë listë, kjo (mos-përfshirja) të mos vendosë çështjes se nëse entiteti është jo autoritet kontraktues në kuptim të këtij ligji;dhe
  - të ndër veprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik.
  - të zhvilloj dhe implementoj rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese.

#### **4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI**

Fushëveprimi i KRPP-së përcaktohet me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ku si fushëveprim kryesorë ka përgjegjësitë e rregullatorit në sektorin e prokurimit publik në Kosovë (përgaditja e legjislacionit dytësorë, interpretimeve dhe opinioneve në prokurim publik, monitorimi i zbatimit të legjislacionit në prokurim publik, trajnimeve, etj), dhe me aplikimin e prokurimit elektronik i është shtuar edhe përgjegjësia e ofruesit të shërbimeve gjithashtu.

##### **4.1 Parimet themelore te funksionimit**

Komisioni Rregullativ per Prokurimit Publik, edhe për sa i përket mënyrës së organizimit dhe funksionimit, mbështetet në Nenit 142 (Kapitulli XII) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Pjesës VI të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Ligjin e administratës shtetërore L-06-113, Rregulloren nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura.

Bordi i KRPP-se mbështetur në nenin 90 te LPP-se dhe në bazë të nenit 7 të Rregullores së punës së KRPPsë, ka miratuar Rregullore Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.

Aktualisht, këto rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit, janë detajuar në Rregulloren nr 01/2020. Kjo rregullore përfshinë kornizimin në mënyrë më të plotë, të organizimit të funksionimit të KRPP-se, duke përfshirë kompetencat e Bordit te KRPP-se dhe administratën e institucionit.

Komisioni Rregullativ per Prokurim Publik me veprimtarinë e saj në cilësinë e një agjencie të pavarur rregullatorë përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, luan gjithashtu nje rol te rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes në mesin e AK dhe OE per zbatimin e drejte te kornizën ligjore per prokurimit publik në zhvillimin sa me te drejte dhe efikas te procedurave te prokurimit nga AK, duke synuar parandalimin e cdo veprimi kundërligjor qe cenon interesin publik në radhe te pare, interesin e palëve te interesit, cenon parimin e transparencës, barazisë, si dhe konkurrencës, e per me tepër përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe eficence te fondeve publike.


## 4.2 Struktura organizative e KRPP-së

Struktura organizative e KRPP-së është e rregulluar sipas *Rregullores Nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik*, dhe ka përbërjen si në vijim:

- Bordi
- Departamenti i Rregullave (DRr) ,
- Departamenti i Monitorimit (DM) ,
- Departamenti për Trajnime dhe Integrimi (DTI) ,
- Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik (DSPE)
- Divizioni për Hartim të Legjislacionit,
- Divizioni për Interpretime,
- Divizioni i Monitorimit ,
- Divizioni për Analizë dhe Statistikë ,
- Divizioni për Trajnim,
- Divizioni për Integrimi,
- Divizioni i TI-së për Administrim të Sistemit të Prokurimit Elektronik, Elektronik.
- Divizioni për Procese të Prokurimit
- Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta (DSHP),
- Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (ZPMBNJ) ,
- Zyrtari Përgjegjës për Prokurim (ZPP)
- Zyrtari Përgjegjës për Financa

Struktura organizative e KRPP-së me përbërjen e listuar më lartë, paraqitet edhe me **organogramin** si në vijim:

**Organogrami i KRPP-së**



Institucioni i KRPP-së është i vendosur ne hapësirat dhe zyret e bodrumit/perdhesës në Ndertesën e ish-Germise, Zona B, të cilat vlerësohet se janë hapësira jo standarde për punë dhe konsiderohen si ambient me rrezikshmëri të lartë për shëndetin e njeriut, gjithmone duke patur parasyshtë që:

- Shumica e hapësirave janë pa dritare të mjaftueshme (ose fare pa dritare), me pamjaftueshmeri të oksigjenit dhe ndriqimit natyral, me lagështi dhe kundërmim nga ambienti i papastër.

Në lidhje me këtë KRPP edhe gjatë vitit 2023 disa herë i është drejtuar ministrisë përkatëse (MPB) për të siguruar lokacion të ri për KRPP-në, por ende nuk është bërë ndonjë zgjidhje.

### 4.3 Bordi i KRPP-së

Sipas nenit 89 te *Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092*, Bordi i KRPP-së përbëhet prej tre (3) anëtarëve. Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat prej 5 (pesë) vjeçar pa të drejtë riemërimi.

Kryetari i KRPP-se është emëruar nga Kuvendi i Republikës se Kosovës me vendimin e datës 02.11.2018 per një mandat pese (5) vjeçar, ndërsa dy anëtarëve të bordit të KRPP-se janë emëruar me vendimin e datës 19.04.2022 per një mandat pesë (5) vjeçar.

Puna dhe organizimi i bordit të KRPP-së është i rregulluar me Nenin 90 të LPP-së, derisa çështjet që janë trajtuar në vendimmarrjen e Komisionit Rregullativ per Prokurim Publik gjatë vitit 2023 kanë pasur të bëjnë me:

- (i) Formimi i komisioneve për trajtimin e kërkesave për revokimin e certifikatave;
- (ii) Shqyrtimi dhe shqiptimi i masave për zyrtarët përgjegjës të prokurimit;
- (iii) Formimi i komisioneve vlerësuese për procedurat e rekrutimit;
- (iv) Vendimet për caktimin e zyrtarëve për përdorim të SIMFK-se;
- (v) Vendimi për ndryshimin e logos;
- (vi) Vendimet për caktimin e komisioneve për vlerësim të testeve për certifikim në prokurim publik;
- (vii) Veprimet procedurale të menaxhimit ditore për zyrtarët e KRPP-se.

Rreth punës së bordit të KRPP-së për periudhën raportuese, në tabelen më poshtë janë paraqitur të dhëna mbi mbledhjet dhe vendimet gjatë vitit 2023, përfshirë edhe përshkrimin e vendimeve.

**Vendimet e Bordit të KRPP-së për vitin 2023**

	<b>Nr. i Vendimit</b>	<b>Data</b>	<b>VENDIM</b>
<b>1</b>	01/2023	5/1/2023	Për themelimin e grupit të vlerësimit për klasifikim të pozitive;
<b>2</b>	02/2023	11/1/2023	Për caktimin e komisionit për trajtimin e kërkesës së Departamentit të Monitorimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim Emergjent me material medicinal për Hemodializë për nevojat e SHSKUK";
<b>3</b>	03/2023	18/01/2023	Për caktimin e zyrtarëve për përdorim të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës;
<b>4</b>	04/2023	26/01/2023	Për ndryshimin e Logos së KRPP-së;
<b>5</b>	05/2023	27/01/2023	Për ndryshimin e webfaqes së KRPP-së dhe lansimin e platformës facebook;
<b>6</b>	07/2023	7/2/2023	Për caktimin e komisionit për përpilimin dhe vlerësimin e testeve që do të mbahet me datë 08/02/2023 për pjesëmarrësit e programit themelor në prokurim;
<b>7</b>	08/2023	9/2/2023	Për pagesën në vlerë prej 140 euro, pra 25% të një page mesatare në Kosovë.
<b>8</b>	10/2023	10/2/2023	Për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për pjesëmarrësit e programit themelor profesional për prokurim, të mbajtur gjatë vitit 2022/2023;
<b>9</b>	11/2023	2/3/2023	Për paralajmërim me shkrim për zyrtarët e SHSKUK pas shkeljeve të evidentuara;
<b>10</b>	12/2023	3/3/2023	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me aktivitetin e Prokurimit "Ndërtimi i Kolektorit në Hajvali"
<b>11</b>	15/2023	3/3/2023	Për ndryshimin e vendimit të KRPP-së i datës 03/03/2023 me nr. 12/2023 për caktimin e komisionit për trajtimin e kërkesës së OSHP lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Kolektorit në Hajvali" me nr. Prot. 616-22-5630-5-1-1 ndaj ZPP të Komunës së Prishtinës;
<b>12</b>	16/2023	3/3/2023	Për Ndryshim/Plotësimin e vendimit të KRPP me numër 07/2023, të dt. 07/02/2023 për caktimin e komisionit për përpilimin dhe vlerësimin e testeve që do të mbahen me datë 08/02/2023;
<b>13</b>	17/2023	3/3/2023	Për formimin e Komisionit të Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë/KVLB për pozitën Udhëheqës i Prokurimit;
<b>14</b>	18/2023	3/3/2023	Për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë/KVLB për pozitën Ekspert për çështje ligjore dhe monitorim;
<b>15</b>	24/2023	28/03/2023	Për aprovimin e kërkesës për pushim mjekësor me pagesë 70% për një periudhë 3 mujore.

## Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik - RAPORT VJETOR 2023

16	24/2023	20/04/2023	Refuzohet si e pabazuar kërkesa e Organit Shqyrtues të Prokurimit e datës 28/02/2023, e parashtruar në bordin e KRPP-së, për anulimin e certifikatës profesionale për ZPP të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës; Shqiptohet vërejtje me shkrim;
17	32/2023	2/5/2023	Për formimin e Komisionit të vlerësimit për ngritje në detyrë/KVND për pozitën: Udhëheqës i Divizionit për Procese të Prokurimit Elektronik;
18	33/2023	18/05/2023	Për caktimin e komisionit i cili do të bëjë pranimin e pasurive jofinanciare: pajisje të IT - kompjuter
19	37/2023	5/6/2023	Për caktimin e zyrtarëve për përdorim të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës
20	40/2023	21/06/2023	Për formimin e Komisionit të vlerësimit për ngritje në detyrë/KVND për pozitën: Udhëheqës i Divizionit për Prokurim;
21	42/2023	2/7/2023	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me aktivitetin e Prokurimit "Furnizim me materiale të ndryshme zyrtare - Niveli Qendror"
22	44/2023	10/7/2023	Për emërimin e Ekspertit të Jashtëm në fushën e Përzgjedhjes / Vlerësimit të Burimeve Njerëzore, znj. Albulena Ukimeraj me mandat 2 vjeçar;
23	45/2023	10/7/2023	Për caktimin e komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe Montimi i Paneleve Solare në Kuzhinën Qendrore
24	53/2023	13/07/2023	Për formimin e komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë/KVND për pozitën: Drejtor i Departamentit për Sistem të Prokurimit Elektronik
25	54/2023	14/07/2023	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i parkut në fshatin Davidovc Komuna Shtime"
26	55/2023	17/07/2023	Refuzohet si e pabazuar ankesa e dt. 10/07/2023 me nr. të protokollit 42/2023, kundër njoftimit të komisionit për kandidatin e suksesshëm për pozitën:
27	58/2023	21/07/2023	Për formimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil/ KPSHC;
28	67/2023	17/08/2023	Për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë/KVND për pozitën: Udhëheqës i Njësisë së Shërbimit të Menaxhimit Financiar;
29	68/2023	17/08/2023	Për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë/KVND për pozitën: Udhëheqës i Divizionit për Interpretime;
30	69/2023	18/08/2023	Refuzohet si e pabazuar ankesa e Organit Shqyrtues të Prokurimit e dt. 26/06/2023, e parashtruar në Bordin e KRPP-së, për anulimin e certifikatës profesionale për ZPP të Autoritetit Kontraktues - AQP;
31	73/2023	24/08/2023	Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesa e Organit Shqyrtues të Prokurimit e dt. 10/07/2023, e parashtruar në bordin e KRPP-së për anulimin e certifikatës profesionale për ZPP të Autoritetit Kontraktues - Komuna Shtime;
32	74/2023	30/08/2023	Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesa e Organit Shqyrtues të Prokurimit e dt. 10/07/2023, e parashtruar në bordin e KRPP-së për anulimin e certifikatës profesionale për ZPP të Autoritetit Kontraktues - Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qendrore;

## Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik - RAPORT VJETOR 2023

33	80/2023	1/9/2023	Për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë/KVLB për pozitën Drejtor i Departamentit të Monitorimit;
34	86/2023	6/9/2023	Për caktimin e komisionit për plotësim/ndryshimin e Rregullores së Punës së KRPP dhe plotësim/ndryshimin e Rregullores nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të KRPP;
35	90/2023	15/09/2023	Ndryshohet pika 4 dhe pika 6 e vendimit nr. 03/2023 të dt. 18 janar 2023 të caktimin e zyrtarëve për përdorim të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës;
36	95/2023	22/09/2023	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë pranimin e " Furnizim me material të ndryshëm zyrtar"
37	96/2023	22/09/2023	Për Formimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë/KVND për pozitën: Drejtor i Departamentit të Rregullave;
38	98/2023	27/09/2023	Për caktimin e Komisionit për Trajtimin e Kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit e dt. 22/09/2023 mr nr. 62/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit"
39	99/2023	29/09/2023	Ndryshohet pika 3 e vendimit nr. 90/2023 i dt. 15/09/2023, për caktimin e komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit të dt. 22/09/2023 me nr. 62/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit"
40	100/2023	29/09/2023	Në bazë të kërkesës së AIP, caktohet znj. Pranvera Krasniqi Sallahu si person përgjegjës për Mbrojtjen e të dhënave dhe hartimin e politikave të Privatësisë;
41	101/2023	4/10/2023	Për formimin e Komisionit për Hartimin e Planit Vjetor të Performancës
42	102/2023	10/10/2023	Paga sekondare
43	103/2023	10/10/2023	Dëshmime të ofruara, i pranohet përvoja e punës prej 6 viteve e 8 muaj;
44	106/2023	26/10/2023	Për caktimin e Komisionit që do të bëjë regjistrimin e Depos së KRPP-së;
45	107/2023	26/10/2023	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë inventarizimin e pasurive jofinanciare të KRPP-së;
46	108/2023	26/10/2023	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë vlerësimin e pasurive jofinanciare të KRPP-së;
47	117/2023	1/11/2023	Aprovohet kërkesa e Organit Shqyrtues të Prokurimit për marrjen e masave për ZPP në Autoritetin Kontraktues - Komuna e Rahovecit;
48	118/2023	3/11/2023	Për caktimin e Komisionit për përpilimin e testeve për programin e trajnimeve profesionale (të avancuara) në prokurim;
49	119/2023	3/11/2023	shfrytëzimi i pushimit të lehonisë prej 12 muajve;
50	120/2023	3/11/2023	Lejohet shfrytëzimi i pushimit të lehonisë prej 12 muajve;
51	122/2023	6/11/2023	Për plotësim/ndryshimin e vendimit nr.37/2022 të dt. 08/09/2022 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - Emërohet kryesues i Komisionit për revokim të certifikatës profesionale të prokurimit z. Ismajl Rushiti, me mandatin i cili është vazhdimësi e vendimit 07/2022;
52	127/2023	9/11/2023	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Kryeshefit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të datës 31/10/2023 me nr. 74/2023 ndaj ZPP të Autoritetit Kontraktues - ASK;
53	128/2023	15/11/2023	Për plotësim/ndryshimin e vendimit nr.127/2023 të dt. 09/11/2023 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik



## Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik - RAPORT VJETOR 2023

54	129/2023	17/11/2023	Për caktimin e Komisionit për Vlerësimin e Testeve për programin e trajnimeve profesionale (të avancuara) për prokurim;
55	130/2023	23/11/2023	Për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me testet e mbajtura më 21/11/2023 për programin e trajnimeve profesionale (të avancuara) për prokurim;
56	133/2023	1/12/2023	Për plotësim/ndryshimin e vendimit nr. 130/2023 të dt. 23/11/2023 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për emërimin e anëtarit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave;
57	136/2023	19/12/2023	Për caktimin e Komisionit për rivlerësimin e testeve për programin e trajnimeve profesionale (të avancuara) për prokurim;
58	137/2023	19/12/2023	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e ankesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit të dt. 14/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i rrugës nacionale N25, Prishtinë-Besi-Podujevë, ndaj ZPP të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Infrastrukturës;
59	138/2023	19/12/2023	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e ankesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit të dt. 14/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit Fehmi dhe Xhevë Lladrovci - Drenas", ndaj ZPP të Autoritetit Kontraktues - KK Drenas;
60	140/2023	22/12/2023	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë pranimin e mallit për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Material Zyrtar - Letër";
61	141/2023	22/12/2023	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë pranimin fizik të pajisjeve të Teknologjisë Informative;

## 4.4 Departamentet dhe divizionet e KRPP-së

### Departamenti i Rregullave

Misioni i Departamentit të Rregullave është të vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin e LPP-së si dhe interpretime në fushën e prokurimit publik si dhe nxjerrjen e formularëve dhe përgatitjen e legjislacionit sekondar.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Rregullave janë:

- Harton planin e punës për departamentin
- Vendos rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të LPP-së nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilës nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të LPP-së me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara nga LPP-ja si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-së për prokurim
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë
- Koordinon punën në zhvillimin e dokumenteve strategjike lidhur me prokurimin publik të cilat hartohen nga strukturat e KRPP-së
- Mbikëqyr pranimin e kërkesave dhe dokumenteve të bashkëngjitura të parashtruara nga palët e interesuara vlerëson nëse nevojitet kompletim apo sqarim
- Bashkëpunon me departamentet tjera në kuadër të institucionit për funksionimin sa më të mirë të punëve që lidhen me politikën e prokurimit.

Drejtori i Departamentit të Rregullave raporton tek Kryetari i KRPP-së.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet në vijim:

- Divizioni për Legjislacion
- Divizioni për Interpretime.

### Departamenti i Monitorimit

Misioni i Departamentit të Monitorimit është të vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të LPP-së dhe rregullave të nxjerra nga KRPP-ja sipas autorizimit të LPP-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Monitorim janë:

- Harton planin e punës për departamentin
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime për sistemin dhe legjislacionin për prokurim me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe përgjegjësisë në punë
- Përgatit dhe zbaton një metodologji dhe mekanizëm të përshtatshëm raportimi të mbështetur nga sistemi elektronik i prokurimit dhe/ose një sistem tjetër të menaxhimit të informacionit që i mundëson të vëzhgojë zbatimin e këtij ligji

- Përgatit raporte mbi rezultatet dhe zbatimin që identifikojnë përparësitë dhe dobësitë në zbatimin e këtij ligji ose sistemi të prokurimit
- Identifikon ato fusha që kanë nevojë të përmirësohen dhe zhvillohen
- Përgatit raportet vjetore që kërkohen nga ky ligj në mënyrë që të japin një vlerësim të përgjithshëm por të saktë të gjendjes së sistemit kombëtar të prokurimit si dhe vlerësime të veçanta të shkallës së përputhjes/mospërputhjes nga autoritetet individuale kontraktuese
- Bën rekomandimet e duhura për ndryshimin e legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e prokurimit publik.

Udhëheqësi i Departamentit për Monitorim raporton tek Kryetarit i KRPP-së.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet në vijim:

- Divizioni për Monitorim dhe Mbikëqyrje
- Divizioni për Analizë dhe Statistika.

### **Departamenti për Trajnime dhe Integritime Evropiane**

Misioni i Departamentit për Trajnime dhe Integritime Evropiane është të zhvillojë dhe organizojë trajnime për programin Themelor Profesional dhe për programin e Avancuar profesional për prokurim sipas nenit 25 të LPP-së si dhe për çështjet që lidhen me prokurimin publik sa i përket procesit të integritimit evropian dhe më gjerë, kompetencë kjo e KRPP-së sipas nenit 87 të LPP-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Trajnime dhe Integritime Evropiane janë:

- Harton planin e punës për departamentin
- Zhvillon module të trajnimit dhe kurikulës për kualifikimet në prokurim të zyrtarëve të Prokurimit për trajnime Themelore dhe të Avancuara (Nivelin Qendror dhe Lokal, OE, OJQ) duke përgatitur katalogun, programet, modulet për trajnime
- Identifikon personat me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP-ja për Trajnim Themelor dhe të Avancuar dhe për trajnime të tjera
- Harton një listë të dokumentuar të kualifikimeve për certifikim si trajnerë dhe si pjesëmarrës në trajnimet e prokurimit. Lista e kualifikimeve publikohet në ueb-faqen e KRPP-së.

Drejtori i Departamentit për Trajnime dhe Integritime raporton te Kryetari i KRPP-së.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet në vijim:

- Divizioni për Trajnim dhe
- Divizioni për Integritime.

## Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik

Misioni i Departamentit për Sistem të Prokurimit Elektronik është të udhëheqë dhe administrojë të gjitha shërbimet e TI-së që janë në funksion të sistemit të prokurimit elektronik.

- Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të departamentit për sistem të prokurimit elektronik janë:
  - Siguron operimin dhe funksionim e pandërprerë të shërbimeve që ofrohen nga platforma e prokurimit elektronik
  - Udhëheq dhe menaxhon në baza ditore të gjithë stafin e TI-së përgjegjës për administrim dhe përkrahje të sistemit të prokurimit elektronik në KRPP
  - Analizon dhe vlerëson në baza ditore funksionimin, operimin dhe performancën e sistemit të prokurimit elektronik të implementuar në KRPP, përfshirë analizimin dhe aprovimin e propozimeve për avancim, modifikim, riparim dhe përditësim të moduleve dhe funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik
  - Planifikon dhe përgatit në mënyrë të detajuar planet 6 (gjashtë) mujore dhe vjetore mbi përditësimet, përmirësimet dhe avancimet e sistemit të prokurimit elektronik për pjesën harduerike dhe softuerike të sistemit
  - Përgatit dhe përditëson politikat e sigurisë dhe procedurat standarde të operimit të platformës së prokurimit elektronik për t'u zbatuar nga stafi i TI-së
  - Ofron këshillime për menaxhmentin e KRPP-së në lidhje me çfarëdo që ndërlidhet me sistem të prokurimit elektronik
  - Bashkëpunon me të gjitha palët e interesit dhe në lidhje me platformën e sistemit të prokurimit elektronik
  - Shërben si pikë koordinuese me të gjitha palët në nivel qeveritar (MAP, MF, etj.) të përfshira në funksionim dhe operim të sistemit të prokurimit elektronik.

Drejtori i Departamentit raporton tek Kryetari i KRPP-së.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si vijon:

- Divizioni i TI-së për Administrim të Sistemit të Prokurimit Elektronik, dhe
- Divizioni për Procese të Prokurimit Elektronik.

### **Zyrtari përgjegjës për Financa**

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit për Buxhet dhe Financa janë:

- Përgatit propozimet buxhetore në koordinim me strukturat organizative të ministrisë
- Koordinon çështjet buxhetore për të gjitha strukturat organizative të ministrisë
- Siguron që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore si dhe raporton mbi ekzekutimin buxhetor
- Monitoron rrjedhën e parasë, llogaritë, transaksionet dhe parametrat tjerë financiar që tregojnë performancën financiare të KRPP-së
- Menaxhon rezervat e parasë dhe siguron se kontrolli i brendshëm financiar është i bazuar në parimet e llogaridhënies
- Siguron bashkëpunim të ngushtë me auditorin e brendshëm dhe të jashtëm në përgatitjen e pasqyrave buxhetore dhe financiare të auditimit.

Zyrtari përgjegjës për Financa raporton tek Kryetari i KRPP-së.

### **Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Shërbimeve të Përbashkëta janë:

- Ofron ndihmë logjistike për takimet e personelit të KRPP-së
- Siguron mbështetje me shërbimet e teknologjisë së informacionit për ministrinë
- Menaxhon inventarin dhe depot e KRPP-së
- Koordinon kërkesat dhe nevojat e KRPP-së për mallra dhe pajisje të zyrës për punë
- Menaxhon nevojat e transportit dhe automjetet e KRPP-së
- Mirëmban dhe administron sistemin e arkivit të KRPP-së
- Menaxhon me zyrën pritëse të KRPP-së.

Udhëheqësi për shërbime të përbashkëta raporton tek Kryetari i KRPP-së.

### **Zyrtari përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore**

Zyrtari për menaxhimin e burimeve njerëzore ka mision zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe procedurave lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë:

- Analizimi i nevojave të punësimit, zhvillimi i planit të personelit, koordinimi dhe sigurimi i procesit të rekrutimit si dhe përgatitja e përshkrimeve të punës
- Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për zhvillimin e kapaciteteve të personelit, sigurimi i trajnimeve adekuate dhe vlerësimi i ndikimit të trajnimeve
- Menaxhimi dhe mbështetja e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të personelit
- Sigurimi i kompensimeve dhe përfitimeve të tjera për personelin sipas legjislacionit në fuqi
- Menaxhimi i veprimeve disiplinore dhe mosmarrëveshjeve midis punonjësve ose ndërmjet

punonjësve dhe menaxhmentit

- Sigurimi i realizimit dhe mbrojtja e të drejtave të punësuarave sipas legjislacionit në fuqi.

Zyrtari përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore raporton tek Kryetari i KRPP-së.

### **Zyrtari përgjegjës për Prokurim**

Zyra e prokurimit ka si mision të sigurojë që të gjitha aktivitetet e prokurimit të institucionit të jenë në pajtim me dispozitat e legjislacionit dhe rregullave të prokurimit si dhe zhvillimin e strategjive dhe dokumenteve të prokurimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit përgjegjës për Prokurim janë:

- Përgatit, koordinon dhe zbaton planin vjetor të KRPP-se në fushën e prokurimit publik, në pajtim me legjislacionin në fuqi
- Siguron që të gjitha kërkesat e prokurimit janë përgatitur dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e prokurimit
- Përcakton metodologjinë e prokurimit për tender dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve
- Ofron këshilla dhe asiston menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave
- Koordinon dhe bashkëpunon me Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), Komisionin Rregullator të Prokurimit Publik (KRPP) dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) sa i përket procedurave të prokurimit publik.

Udhëheqësi i Prokurimit raporton tek Kryetari i KRPP-së

### Burimet njerëzore

Numrit i pozitave të aprovuara, sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike - numri total i punonjësve, vijon të jetë i njëjtë me vitin paraprak, në një numër total prej 42 pozitave. Struktura themelore organizative e KRPP-së përbëhet nga Bordi, katër departamente, nëntë divizione dhe tri njësi.

Bazuar në aktet nënligjore të sipërcituara, struktura organizative e Komisionit Rregullativ për Prokurimit Publik me kategorizim të pozicioneve është si më poshtë:

Pozita	Kategoria	Nr. i zyrtarëve
<b>Kryetar</b>		1
<b>Anëtar i Bordit</b>		2
<b>Asistente e lartë</b>		1
<b>Departamenti i Rregullave</b>		
Drejtori i Departamentit	Drejtues i mesëm	1
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	2
Ekspert	Profesional	2
Zyrtar i lartë	Profesional	1
Zyrtar	Profesional	1
<b>Departamenti i Monitorimit</b>		
Drejtori i Departamentit	Drejtues i mesëm	1
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	2
Ekspert	Profesional	5
Zyrtar	Profesional	2
<b>Departamenti për Trajnime dhe Integritet</b>		
Drejtori i Departamentit	Drejtues i mesëm	1
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	2
Ekspert	Profesional	1
Zyrtar	Profesional	3
<b>Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik</b>		
Drejtori i Departamentit	Drejtues i mesëm	1
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	2
Ekspert	Profesional	3
Administrator i Bazës së të dhënave	Profesional	2
<b>Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta</b>		
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	1
Zyrtar	Profesional	2
<b>Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore</b>		
Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Drejtues i ulet	1
<b>Njësia për menaxhimin e financave</b>		
Zyrtari Përgjegjës për Financa	Drejtues i ulet	1
<b>Njësia për prokurim publik</b>		
Zyrtari Përgjegjës për Prokurim	Drejtues i ulet	1

Tabela 2



Ne lidhje me këtë strukturë, edhe gjatë vitit 2023 KRPP ka vazhduar të fokusohet në rritjen e kapaciteteve të stafit për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e punës në institucion. Një nga qëllimet kryesore ishte funksionalizimi i strukturës organizative, për të siguruar një përshtatje të mëtejshme me nevojat dhe synimet tona.

Gjatë vitit 2023, KRPP ka zhvilluar dhe zbatuar një sërë procedurash të rekrutimit përmes lëvizjeve paralele , avancimeve dhe pranimit në shërbimin civil . Konkretisht, janë realizuar në total nëntë (9) procedura të rekrutimit/lëvizjeve paralele, tetë (8) procedura të rekrutimit/avancimit dhe një (1) procedurë e rekrutimit/pranim në shërbimin civil. Ky angazhim i vazhdueshëm për të rritur potencialin e stafit dhe për të identifikuar kapacitete të reja ka pasur një impakt të rëndësishëm në zhvillimin organizativ të KRPP-së.

Në përfundim të vitit 2023, përmes nëntë (9) shpalljeve të rekrutimit avancim në karrierë dhe procedurës pranim në shërbimin civil , me sukses janë përmbyllur pesë (5) nga këto procedura të rekrutimit. Kjo është një arritje e rëndësishme për organizatën tonë dhe dëshmon përkushtimin tonë për të siguruar një proces rekrutimi të drejtë dhe të suksesshëm për kandidatët potencialë.

Aktualisht, nga një total prej 32 punonjësve në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik, 20 janë femra dhe 12 janë meshkuj. Nga këta të gjithë ,32 janë me arsim të lartë, ndërsa një person është me arsim të mesëm.

Në vitin 2023, ndonëse janë planifikuar shpenzime të fondeve buxhetore për personelin e KRPP-së, është hasur në disa sfida në realizimin e tyre. Kjo ka ndodhur për shkak të dy faktorëve kryesorë. Së pari, mosplotësimi i vendeve vakante të miratuara në strukturën organizative të KRPP për shkak të përfundimit pa fitues të procedurave të rekrutimit të shpallura nga KRPP-ja gjatë këtij viti. Së dyti, disa largime me dorëheqje të punonjësve të institucionit, e cila ka ndikuar në rritjen e paplanifikuar të pozicioneve vakante të punës.

Megjithatë, Komisioni i Rregullativ për Prokurim Publik vazhdon të fokusohet në rritjen e kapaciteteve të stafit. Në këtë kontekst, në bashkëpunim të ngushtë me IKAP-in, kemi siguruar pjesëmarrjen e rregullt në trajnime të zhvilluara nga kjo e fundit. Kemi vënë në dispozicion të stafit kalendaret e trajnimeve dhe kemi inkurajuar pjesëmarrjen në trajnimet sipas fushave të interesit të secilit. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, katër (4) punonjës të KRPP-se kanë marrë pjesë në trajnimin e avancuar për prokurim publik dhe dy (2) nëpunës kanë marrë pjesë në trajnimin me temë "Analiza statistikore dhe interpretimi ".

## 5. AKTIVITETET E KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK

Në këtë pjesë të raportit paraqiten të dhënat mbi punën dhe aktivitetet kryesore të departamenteve të KRPP-së për periudhën raportuese dhe të cilat aktivitete kanë qenë në funksion të përmirësimit dhe avnacionit të sistemit të prokurimit publik në tërësi dhe në përmbushjen e objektivave të planifikuar dhe arritjen e rezultateve të pritura nga KRPP.

### 5.1 Aktivitetet e Departamentit të Rregullave

Në përputhje me LPP-në dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, Departamenti i Rregullave (DRr) pranë KRPP-së kryen aktivitetet për të realizuar objektivat e këtij departamenti të përcaktuara në Planin e punës për vitin 2023, si në vijim:

- *Përditësimin e akteve dytësore, rregullave dhe udhëzimeve, si dhe formularëve Standard për unifikimin e praktikave në fushën e prokurimit publik dhe harmonizimin me direktivat e BE-së;*
- *Dhënien e opinioneve, këshillave apo udhëzimeve sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;*
- *Dhënien e interpretimeve të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik.*

Qëllimi kryesor i Departamentit të Rregullave krahas funksionimit dhe avancimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë është ngritja e shkallës së përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese të cilat financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, si dhe sigurimi i mënyrës më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke ofruar asistencë për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj. Gjithashtu, ky departament synon të vazhdojë edhe më tutje që të përqendrojë përpjekjet e këtij departamenti drejt maksimizimit të ndikimit që prokurimi ka në vlerën për paranë, cilësinë dhe qëndrueshmërinë. Duke qenë se prokurimi publik luan një rol jetik në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve në mënyrë efikase, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, është thelbësore të sigurohet që fondet dhe burimet publike të përdoren siç duhet dhe blerjet të marrin parasysh ndikimin afatgjatë në shoqëri dhe mjedis.

Gjatë vitit 2023, Departamenti i Rregullave përveç nxjerrjes së akteve dytësore për prokurim publik, ka luajtur një rol aktiv në dhënien e këshillave, opinioneve dhe interpretimeve me shkrim palëve të interesuara (autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik) përmes arkivit të KRPP-së dhe adresës zyrtare elektronike “rregullat.krpp”, por edhe përmes telefonit zyrtar, si dhe përmes konsultave në zyrën e DRR pranë KRPP-së.

Gjatë kësaj periudhe kohore të raportimit, Departamenti i Rregullave me qëllim të funksionimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, duke vlerësuar se legjislacionit të prokurimit publik i mungojnë dy dokumente të rëndësishme që do t'i ndihmonin autoritetet kontraktuese të realizojnë një hulumtim të mirëfilltë të tregut të brendshëm dhe të jashtëm për të përcaktuar më saktë vlerën e parashikuar të kontratave dhe për të parë më saktë se çfarë ofron tregu, si dhe me qëllim të rritjes së cilësisë së furnizimeve, shërbimeve dhe punëve, Departamenti i Rregullave punoi në mënyrë intensive dhe në bashkëpunim me ekspertët e Projektit të BE për mbështetje të KRPP-së, përgatiti dhe publikoi në e-prokurim këto dy dokumente:

1. *Manual për përdorimin e kriterit “Tenderi Ekonomikisht më Favorshëm”*
2. *Udhëzim për Hulumtimin e tregut;dhe*
3. *Manual përdorimi për Autoritetet Kontraktuese – Kërkesat për rishqyrtim dhe ankesat.*


Nxjerrja e Manualit për përdorimin e kriterit “Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF)”, bazuar në të dhënat e monitorimit të aktiviteteve të prokurimit të iniciuara nga autoritetet kontraktuese dhe të monitoruara nga Departamenti i Monitorimit në KRPP, rezulton rritjen e përdorimit të kriterit TEMF, krahasuar me vitet paraprake, ngase dokumenti në fjalë mundëson që autoritetet kontraktuese të mund të përcaktojnë në dokumentet e tenderit (Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë) specifikimin e saktë të kriterëve që lidhen me cilësinë e produktit, kriterëve mjedisore, sociale dhe/ose ciklit jetësor të produkteve duke garantuar efikasitet më të lartë dhe kosto më të ulët për autoritetin kontraktues.

Që nga data 30.10.2009, kur Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, për herë të parë themeloi “tavolinën ndihmëse” me qëllim të ofrimit të këshillave profesionale, interpretime të dispozitave të ligjit dhe të legjislacionit dytësor, me kërkesë të autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik, si dhe palëve tjera të interesuara çdo ditë pune në tel. + 381 (0) 38 213 709, si dhe në e-mailin zyrtar të Departamentit të Rregullave: “rregullat.krpp@rks-gov.net”, deri më tani, është vlerësuar të funksionojë mjaft mirë, sepse me angazhimin maksimal, efikasitetin dhe shkathtësinë e ekspertëve të prokurimit të këtij departamenti, që nga 1 Janari e deri më 31 Dhjetor të vitit 2023, kanë arritur të ofrojnë në total *Njëmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre (1.673)* këshilla/interpretime përmes arkivit të KRPP-së, adresës zyrtare (elektronike) “rregullat.krpp@rks-gov.net”, drejtpërdrejtë në takime konsultative me palët e interesuara, si dhe përmes telefonit, si në vijim:

Rreth numrit të interpretimeve të përgaditura dhe lëshuara nga departamenti i rregullave në kërkesat e Autoriteteve kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomik, më poshtë në *Tabelën Nr.1* do paraqitet numri i kërkesave dhe përgjigjeve gjatë periudhës raportuese (2023), ndërsa në Grafikon Nr.1 paraqitet numri i kërkesave dhe përgjigjeve për interpretime ( pa përfshirë numrin e përgjigjeve në linjë telefonike dhe konsultat) sipas viteve paraprake dhe vitit raportues 2023.

Nr	Mënyra e dhënies së përgjigjeve	Përgjigjet e dhëna për Autoritetet Kontraktuese	Përgjigjet e dhëna për Operatorët Ekonomik	Totali i përgjigjeve
1	Interpretime me shkrim (përmes arkivit të KRPP-së)	28	6	34
2	Interpretime përmes adresës elektronike të KRPP-së	184	186	370
3	Interpretime përmes telefonit zyrtar të KRPP-së	628	509	1137
4	Takime-Konsulta	82	50	132
5	Totali i përgjigjeve për AK dhe OE	922	751	1673

Tabela 1



Grafiku 1

Krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 është zvogëluar dukshëm numri i kërkesave për këshilla/interpretime dhe opinione të parashtruara nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik. Bazuar në të dhënat e pasqyruara për dy vite, mund të konstatohet se nga gjithësej 3.360 kërkesa në vitin 2022, është zvogëluar numri i kërkesave në 1.673 në vitin 2023, apo mbi 50% rënie të kërkesave në vitin 2023 si rezultat i publikimit të interpretimeve/opinioneve në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik - në linkun “Informacione” vegëza “Interpretime” **15 interpretime** në vitin 2023 nga gjithësej 35 interpretime të publikuara deri më tani, si dhe tek vegëza “Opinione” janë publikuar **5 opinione** në vitin 2023 nga gjithësej 15 opinione të publikuara deri më tani në <https://e-prokurimi.rks.gov.net>

<b>INTERPRETIME të publikuara gjatë vitit 2023</b>	
<b>Pyetja:</b>	<b>Sqarimi:</b>
35. 04.12.2023 Si të kalkulohet afati kohor për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së?	KRPP ka sqaruar kalkulimin e afatit kohor për parashtrim të Kërkesës për rishqyrtim nga OE gjatë fazës së tenderimit.
34. 04.12.2023 Sipas nenit 35 të LPP, a konsiderohet aprovim në heshtje e KRPP-së përdorimi i Procedurave të Negociuara pa Publikimin e Njoftimit për Kontratë, kurdo që për këtë njoftohet KRPP nga AK?	KRPP ka sqaruar rolin që i është dhënë me nenin 35 të LPP-së, në bazë të të cilit nen është sqaruar se KRPP nuk aprovon Procedurat e Negociuara pa Publikimin e Njoftimit për Kontratë por thjesht njoftohet nga AK-të për qëllime të raportimit.
33. 24.10.2023 Sipas LPP-së, a duhet të iu lejohet qasja OJQ-ve dhe personave tjerë në dokumentet zyrtare?	KRPP ka sqaruar se LPP rregullon qasjen në dokumente zyrtare vetëm për Operator Ekonomik (“palë e interesuar” siç përkufizohet në nenin 4, paragrafin 1, nën paragrafin 1.26 të LPP-së), ndërsa OJQ-ve dhe personave tjerë duhet lejuar qasjen në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.
32. 24.10.2023 Si duhet të veprojë Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit pasi që komisioni për vlerësimin e tenderëve të ketë dhënë rekomandimin me shkrim?	KRPP ka sqaruar nenin 39.11 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, sipas të cilit nen Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk duhet të vlerësojë tenderët për të marrë një Vendim përfundimtar për dhënien e kontratës, por në rast se nuk pajtohet me rekomandimin e komisionit për vlerësim duhet të njoftoj me shkrim ZKA-për arsyet e refuzimit dhe të kërkojë formimin e një komisioni të ri për ri-vlerësimin e tenderëve.
31. 24.10.2023 Cilat janë veprimet e AK në rast të një kërkesë nga OE për qasje në dokumente zyrtare?	KRPP ka sqaruar veprimet procedurale të AK-së në përputhje me nenin 10 dhe 11 të LPP-së.
30. 22.06.2023 Në rast të Procedurës së Kufizuar, a ka të drejtë OE në fazën e dytë të parashtrijë Kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së dhe ankesë në OSHP me pretendimet ankimore për fazën e para kualifikimit?	KRPP ka sqaruar se: Operatori Ekonomik ka të drejtë të parashtrijë kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues si në fazën e parë (fazën e para kualifikimit), ashtu edhe në fazën e dytë (fazën e dhënies së kontratës), por gjatë fazës së dytë Operatori Ekonomik NUK mund të parashtrijë kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së dhe ankesë në OSHP me pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me fazën e para kualifikimit.
29. 22.06.2023 Sipas nenit 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, në rast se AK kërkon Certifikatë që vërteton përshtatshmërinë e produktit me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, në rast grupi të operatorëve, certifikata e tillë a duhet të kërkohej nga të gjithë anëtarët e grupit apo mjafton njëri nga ata të jetë i pajisur me këtë certifikatë?	KRPP ka sqaruar nenin 70 të LPP-së dhe i ka këshilluar AK-të që në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, t'i specifikojnë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre.

<p>28. 09.06.2023 Në rast të kontratave publike kornizë me çmime njësi, çmimet e peshuara a duhet të realizohen me të njëjtën përqindje (%) gjatë ekzekutimit të kontratës?</p>	<p>KRPP ka sqaruar Kontratat publike kornizë me çmime për njësi në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik si dhe me shembuj konkret ka sqaruar përdorimin e kontratave me çmime njësi.</p>
<p>27. 09.06.2023 A lejohet sipas LPP-së të përdoret metoda ‘Projekto dhe ndërto’?</p>	<p>KRPP ka sqaruar se AK nuk mund të përdorë metodën “Projekto dhe ndërto” sepse sipas paragrafit 10 të nenit 28 të LPP-së, AK obligohet që specifitimeve teknike që janë pjesë e Dosjes së Tenderit t’i bashkëngjitë Projektin Ekzekutiv, ndërsa me qëllim të evitimit të ndonjë konflikti të mundshëm të interesit, në pikën 6 të nenit 75.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, në mënyrë implicite është përcaktuar se “Një OE që ka hartuar një projekt nuk mund të ekzekutojë projektin ((një procedurë e re duhet të iniciohet për kryerjen e punëve).</p>
<p>26. 09.06.2023 A lejohet me LPP të kërkohen Certifikata ISO, kur qartë vërehet se shumica e tyre nuk kanë ndonjë lidhshmëri me objektin e kontratës?</p>	<p>KRPP i ka këshilluar AK-të që me rastin e vendosjes së kritereve apo kërkesave kualifikuese të kenë parasysh që mund të kërkohen vetëm ato Certifikata që janë ngushtë të lidhura me sigurimin e cilësisë dhe kualitetit të lëndës së prokurimit.</p>
<p>25. 09.06.2023 A është në përputhje me LPP-në, nëse AK në Dosjen e tenderit kërkon që OE në Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit të ketë primar aktivitetin i cili është i njëjtë me objektin e kontratës?</p>	<p>KRPP ka sqaruar se një kërkesë e tillë konsiderohet të jetë diskriminuese, prandaj si e tillë nuk duhet të vendoset në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.</p>
<p>24. 29.03.2023 Në rast se AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, specifikon referencën lidhur me qarkullimin financiar si në vijim, citat: “Deklaratë Tatimore vjetore të dorëzuar në Administratën Tatimore të Kosovës”, a mund të pranohet një referencë e tillë e lëshuar nga një autoritet tjetër nga vendi i themelimit të OE-së?</p>	<p>KRPP ka këshilluar AK-të që kurdo që kërkojnë referencën e tillë, për të njëjtën të përshkruajnë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë si në vijim: “Deklaratë Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën tatimore të Kosovës ose nga vendi i themelimit të tyre”</p>
<p>23. 29.03.2023 A konsiderohet shkelje e LPP-së, nëse Autoriteti Kontraktues inicion aktivitetin e prokurimit për dhënien e një kontrate publike-punë pa siguruar të gjitha mjetet financiare për projektin i cili realizohet brenda vitit fiskal, por në mungesë të mjeteve financiare, i njëjti projekt deri në realizimin përfundimtar të tij kalojnë disa vite fiskale ?</p>	<p>Në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, KRPP ka sqaruar se secili autoritet kontraktues është i obliguar që para inicimit të një aktiviteti prokurimi, t’i përmbushë kërkesat e nenit 9 të LPP-së dhe kërkesat e nenit 19.15 (k) të Rregullores për Prokurimin Publik ndërkohë që është i obliguar t’i përmbush dhe kërkesat tjera të LPP-së dhe legjislacionit dytësor. Për çdo aktivitet prokurimi i cili ushtrohet duke mos zbatuar dispozitat e LPP-së në tërësi, përgjegjës janë zyrtarët të cilët kanë kryer veprime si rezultat i shkeljeve të dispozitave të këtij ligji.</p>
<p>22. 29.03.2023 Një zyrtar i cili ka përgatit specifikimet teknike dhe/ose Termet e Referencës, a mund të caktohet Menaxher i Kontratës ?</p>	<p>KRPP ka sqaruar se një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose TER, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura, mund të emërohet Menaxher i Kontratës.</p>



<p>21. 29.03.2023 A mund të kërkojë AK në dosjen e tenderit 50% Sigurinë e ekzekutimit për një kontratë publike ?</p>	<p>Duke qenë se paragrafi 2 i nenit 63 të LPP-së përcakton vetëm minimumin e lartësisë së sigurisë së ekzekutimit, KRPP ka sqaruar se Autoriteti Kontraktues mund të përcaktojë një përqindje më të lartë se 10 % e vlerës së kontratës gjithnjë duke qenë në proporcion me shumën e dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parashihet që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Barra e provës në këtë rast i takon AK-së që të argumentojë në mënyrë të saktë dhe të arsyetuar mjaftueshëm përqindjen (më të lartë se 10%) e sigurisë së ekzekutimit të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, si dhe të sigurojë se një përqindje e tillë nuk bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik (<i>ekonomiciteti dhe efikasiteti, transparencia, konkurrenca, trajtimi i barabartë, jo diskriminimi</i>). Pra, Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet në asnjë mënyrë të përcaktojë një përqindje të lartë të sigurisë së ekzekutimit, nëse me këtë kufizon konkurrencën e operatorëve ekonomik, diskriminon dhe/ose favorizon ndonjë operator ekonomik.</p>
---	--

<p style="text-align: center;"><b>OPINIONET e publikuara gjatë vitit 2023</b></p>	
<p style="text-align: center;"><b>Pyetja:</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Sqarimi:</b></p>
<p>15. 24.10.2023 A lejohen pagesa direkt për anëtarët e grupit të Operatorëve Ekonomik (konzorciumit)?</p>	<p>Në analogji me nenin 30 të LPP-së dhe nenin 17.20 të RRPP të cilat lejojnë pagesat direkt për nënkontraktorët, KRPP ka dhënë opinionin sipas të cilit AK-të mund të lejojnë kur ata e konsiderojnë këtë si të nevojshme t'i kryejnë pagesat direkt për anëtarët e grupit (konzorciumit).</p>
<p>14. 24.10.2023 A mund të nënshkruhen Deklarata nën betim dhe dokumentet tjera të Dosjes së Tenderit në emër të përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar?</p>	<p>Çështjen e Autorizimit nuk e trajton LPP, megjithatë KRPP ka dhënë opinionin si në vijim: Për derisa në Formularët Standard të Dosjes së Tenderit përfshirë “Deklaratën nën Betim” dhe dokumentet tjera (Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, Kërkesa për Sqarim, Formulari i Tenderit etj) në të cilat kërkohen të dhënat mbi identifikimin e përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik (Emri dhe Mbiemri, pozita, nënshkrimi, data dhe vula), pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik, rrjedhimisht të njëjtat dokumente nuk mund të nënshkruhen nga një person tjetër jo kompetent apo që nuk ka autorizim për të nënshkruar dokumentet në fjalë.</p>
<p>13. 22.06.2023 Si duhet të veprojë AK, në rast se një tenderues paraqet ndonjë dokument të tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së?</p>	<p>Meqenëse sipas nenit 13.4 të LPP-së përcakton se tenderët mund të dorëzohen vetëm në Gj. Shqipe, Serbe dhe Angleze, opinionin e KRPP-së është se çdo dokument i dorëzuar në një gjuhë tjetër duhet të jetë i shoqëruar me një përkthim zyrtar të të njëjtit.</p>
<p>12. 09.06.2023 Eksperti (inxhinieri, specialisti) i një fushe specifike, i deklaruar</p>	<p>Për të lejuar zëvendësimin e ekspertit, AK duhet që gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve, të</p>



<p><i>me tender, a lejohet të zëvendësohet gjatë fazës së vlerësimit të tenderëve?</i></p>	<p>përcaktojë nëse eksperti i ri i plotëson kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit në të njëjtin nivel me ekspertin e përcaktuar fillimisht. Nëse eksperti i ri i plotëson të gjitha kushtet në të njëjtin nivel dhe OE e ka demonstruar bindshëm arsyetimin si rezultat i ndryshimit të rrethanave në këtë fazë, autoriteti kontraktues mund të pranojë një zëvendësim të tillë.</p>
<p><i>11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve “të njëjta” dhe “të ngjashme” në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?</i></p>	<p>KRPP ka sqaruar kuptimin e këtyre dy termeve në aspektin gjuhësor. Mirëpo në lidhje me objektin e kontratës një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të fushës përkatëse mund të përcaktojë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.</p>

## 5.2 Aktivitetet e Departamentit të Monitorimit

Aktivitetet e Departamentit të Monitorimit i përbërë nga Divizioni për Monitorim dhe Divizioni për Analizë dhe Statistika për periudhën raportuese përfshijnë aktivitetet në përputhje me kompetencat ligjore të departamentit, respektivisht 81, 88.1 dhe 88.2 të LPP-së nr.04/L-042 në bazë të të cilave departamenti i monitorimit dhe mbikëqyrjes ka kompetencë, autoritet dhe përgjegjësi të vëzhgoj, mbikëqyrë dhe monitoroj zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit detyësorë të nxjerrur nga KRPP-ja sipas autorizimit të këtij ligji.

Në vazhdim të këtij raporti janë paraqitur aktivitetet e punës së departamentit të monitorimi në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik në Kosovë gjatë monitorimit të pajtueshmeris së aktiviteteve të prokurimit me Legjislacioni për Prokurim Publik.

Në funksion të kësaj janë paraqitur rezultatet e punës në kuadër të aktiviteteve të Monitorimit gjatë vitit 2023, rekomadimet e lëshuara, problematikat e konstatuara gjatë procesit të monitorimit të aktiviteteve të Prokurimit dhe monitorimet sipas këkresës nga palët e interesit apo sipas rastit përkatsisht autorizimit zyrtar si dhe veprimet e ndërmarra nga KRPP për shmangien e lëshimeve apo shkeljeve konkrete nga Autoritete Kontraktuese.

Obligimi, autorizimi dhe përgjegjësia për monitorim dhe mbikqyerje të prokurimit publik në Kosovë është e rregulluar sipas LPP-së, derisa forma dhe qasje e llojit apo metodologjisë së monitorimit është përcaktuar nga bordi i KRPP, sipas mandatit të dhënë nga ky ligj,

Mbi këtë bazë lloji i monitorimit i aplikuar edhe gjatë vitit 2023 ka qenë monitorimi ex-sante apo siç njihet monitorimi parparak apo prandalues.

Mekanizmi apo kontrolli ex-sante i referohet monitorimit para përfundimit të një aktiviteti të prokurimit që nënkupton nga publikimi i njoftimit për kontratë deri në afatin e fundit për dorëzim të ofertave nga subjektete interesuara.

Ky lloj monitorimi shërben që aktivitetet e prokurimit publik me përmbajtje të shkeljeve ligjore të parandalohen para dhënies së kontratës si dhe në anën tjetër të identifikohen kriteret diskriminuese apo favorizuese nga autoritetet kontraktuese për palë të caktuara përmes vendosjes së kriterëve për kualifikim. Monitorimi Ex-sante është një metodë apo praktikë e mirë që ka efekt pozitiv në parandalimin e shkeljeve dhe lëshimeve të munëdshme gjatë fazës nga publikimi deri në hapje të ofertave.

Në funksion të kësaj KRPP, në bashkëpunim me USAID, gjate pjesës së parë të vitit 2023 ka hartuar metodologjin e monitorimit të aktiveve të Prokurimit, të cilat kanë filluar të testohen nga 01.06.2023. Kjo metodologji synon të ofrojë një qasje standarde, të ngrisë cilësinë e monitorimit gjatë përdorimit të procedurave përmes indikatorëve (të riskut- flamujt e kuq) të cilët tregojnë rastet për të inicuar procesin e monitorimit. Ofrimi i rekomandimeve për përshtatjen e qasjes së standardizimit të monitorimit duke u bazuar në sfidat e identifikuar gjatë fazës së pilotimit, mbështetjen e integritetit/komunikim me sistemin e-prokurimit, formalizmin e metodologjisë së monitorimit brenda rregullave të brendshme të KRPP-së me qëllim të përmirësimit të monitorimit duke u bazuar edhe në praktikat më të mira ndërkombëtare fillon së aplikuari me kapacitet të plota

nga data 01.01.2024.

Për të sigurua një monitorim sa më efikase (përzgjedhje të mostrave), transparente dhe objektive, KRPP, gjithëashtu ka përgatitur dhe funksionalizuar veglën për monitorim në bazë të indikatorëve të riskut- flamujt e kuq të janë pjesë e platformës së e-prokurimit. Rrjedhimisht, nëse një aktivitet i prokurimit (tender) sinjalizohet nga ndonjëri prej indikatorëve, por jo vetëm, atëherë vegla me automatizëm e liston atë aktivitet i cili ka një indikator apo më shumë dhe i cili do të jete target për monitorim nga ekspertët e Monitorimit.

Një karakteristikë shtesë që vegla e monitorimit e ofron është së përzgjedhjen e aktivitetit të prokurimit për monitorim e sinjalizon vete sistemi elektronik përmes flamujve të kuq dhe komunikimi në mes të zyrtareve të monitorimit të KRPP-së me zyrtaret e prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese është shume ma i lehte dhe lenë gjurme (dokumentim) në sistemin e prokurimit elektronik.

Indikatorët e përcaktuar përmes Platformës së E-Prokurimit, (flamujt të kuq) janë: Vlera e madhe e kontratës - Ky indikator tregon së tenderi futet në kategorinë me Vlerë të madhe;Procedura e negociuar - Ky indikator tregon se është përdorur procedura e negociuar në një tender për secilën nga vlerat;Afatet kohore - Ky indikator tregon se a janë dhënë afatet kohore në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP);Fillimi i vlerësimit - Ky indikator tregon së kanë kaluar 30 ditë nga data e mbylljes dhe akoma nuk ka dhënie të kontratës; Korrigjimi i tenderit - Ky indikator tregon së tenderi ka ndryshime/korrigjime gjatë fazës së publikimit;Përfundimi i vlerësimit dhe dhënia e kontratës - Ky indikator tregon se vlerësimi dhe dhënia e kontratës është përfunduar pas 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Nëpërmjet këtij procesi eshte synuar të eliminohen veprimet jo ligjore nga autoritete kontraktuese dhe ngritja e përgjegjësisë së zyrtarëve të prokurimit për zbatim të drejtë dhe të saktë të legjislacionit të prokurimit publik, me fokus evidentimin e shkaqeve që lidhen me mos respektimin e kërkesave ligjore nga ana e Autoriteve kontraktuese.

Për arritjen e këtij objektiv, target i monitorimit kanë qenë njoftimet për kontratë dhe të gjitha llojet tjera të njoftimve të zhvilluara sipas ndonjërës nga procedurat e prokurimit me theksë të veçantë aktivitetet e prokurimit me vlera të mëdha, përkatsishtë lloji i prokurimit – punë, procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratës.


Bazuar në sqarimet e lartë cekura, subjekt monitorimi kanë qenë të gjitha Autoritet Kontraktuese ( 165 Autoritete Kontraktuese), duke përfshirë 9385 njoftime.

Të gjitha të dhënat e evidentuara nga aktivitetet e monitorimit për periudhën raportuese janë paraqitur me poshtë në tabelat dhe grafikonet përkatëse.

## Të dhëna statistikore mbi aktivitetet e monitorimit

Të dhëna mbi numrin e monitorimeve sipas llojit të procedurës, njoftimit dhe vlerës së procedurës/kontratës gjatë vitit 2023					
	Vlerë e madhe	Vlerë e mesme	Vlerë e vogël	Vlerë minimale	Gjithësej
Njoftime për kontratë	592	1576	324		2492
Njoftim për dhënie të kontratës	335	1056	238	1	1630
Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit	119	350	103		572
Njoftim paraprak	65	11			76
Njoftim mbi rezultatin e konkursit të projektimit	3	6			9
Njoftim mbi konkursin e projektimit	1	9			10
Njoftim për anulimin e dhënies së kontratës	2	2	2		6
Njoftim për informata shtesë ose përmirësim gabimi	362	486	53		901
Njoftim për procedurën e negociuar pa publikim	37	102	24		163
Ftesë për ofertim-shitje			1		1
Njoftim për nënshkrim të kontratës	306	1021	210	19	1556
Njoftim i vendimit të AK para publikimit sipas nenit 43 dhe 44.2 të RRUPP	386	1153	266	9	1814
Ngarkimi i kontratës në sistem të prokurimit elektronik	56	63	17		136
Shërbime të konsulencës		5	1		6
<b>Gjithësej</b>	<b>2264</b>	<b>5840</b>	<b>1239</b>	<b>29</b>	<b>9372</b>

Tabela 3



Grafiku 2


Siq shihet nga grafiku nr.2 në vitin 2023 kemi rënie të numrit të përgjithshëm të njoftimeve të monitoruara në krahasim me vitin paraprak 2022, si rezultat i testimit dhe aplikimit të metodologjisë së re për monitorim, e cila synon në ngritje të cilësisë.

<b>Evidentimi i gjetjeve me numrin më të madh gjatë vitit 2023</b>		
<b>Neni</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Raste</b>
Neni 7 LPP-së	Barazia në trajtim, jodiskriminimi	112
Neni 69 LPP-së	Aftësitë teknike dhe profesionale	112
Neni 17.6 RrPP	Dosja e tenderit (Kushtet e veçanta nuk janë plotësuar)	105
Neni 9 LPP-së dhe	Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së mjeteve	66
Neni 68 LPP-së	kapacitete ekonomike dhe financiare	52
Neni 8 LPP-së	Planifikimi i prokurimit	34
Neni 46 LPP-së	Rregullat e përgjithshme të tenderimit - Shkurtimi i afateve	34
NENi 38 LPP-se dhe 54.15 RrPP	Kontrata kornize	32
Neni 28.dhe 28.10 LPP-së	Specifikimet teknike	30

Tabela 4

<b>Monitorimi i Njoftimeve për anulim të aktivitetit të prokurimit</b>	
<b>Arsyeja e anulimit</b>	<b>Raste</b>
Nuk është dorëzuar asnjë ofertë- tender	142
Nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme	147
Anulim për shkak të tejkalimit të buxhetit	57
Anulim para hapjes së ofertave për shkak të ngjarjeve apo arsyeve objektive dhe të domosdoshme të cilat janë jashtë kontrollit të AK dhe të cilat kanë qenë të paparashikuara në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit	87
Një dispozit e ligjit kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit	66
Një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në proc.e prok.e cila nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një amandamenti ligjor të prokurimit	26
Me vendim të OSHP-së	37
Anulimi është bërë për shkak se nuk janë dërguar çelësat anëtarve të komisionit për hapje	8

Tabela 5



Grafiku 3

Nga të dhënat mbi monitorimin e njoftimeve për anulim, është evidente se në vitin 2023 janë monitoruar rreth 570 raste, që tregon një rënie të dukshme të aktivitetit të monitorimit në krahasim me vitet paraprake për rastet e anulimit të aktiviteteve të prokurimit si rezultat i testimit dhe fillimit të aplikimit të metodologjisë së re për monitorim, e cila ka filluar nga data 01.06.2023.

### **Monitorimi i procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë**

Në vitin 2023 Departamenti i Monitorimit, ashtu siç është paraqitur edhe në tabelën 3 ka monitoruar gjithësej 163 njoftime të procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë nga gjithësej 349 procedura të tilla të zhvilluara gjatë vitit 2023 (duke mos përfshirë prokurimet për punë shtese prej 224 Aktiviteve. Numri i Procedurave të Negociuara pa Publikim duke përfshirë punët shtes është 573 Aktivitete.


Gjatë procesit të monitorimit ka rezultuar se Autoritetet Kontraktuese kane përdorur këtë procedurë për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, për arsye të drejtave ekzkluzive, për punë të paparashikuara apo punë shtesë, si dhe për arsye të emergjencave ekstreme. Nga të dhënat e monitoruara dhe të dhënat e përgjithshme të kontratave të nënshkruara nëpërmjet kësaj procedure, rezulton që përdorimi i kësaj procedure edhe në vitin 2023 mbetet përafërsisht në % të njëjtë me vitin paraprak sipas vlerës, dërsia kemi një rënie të përdorimit të kësaj procedure shprehur në %, në raport me numrin e procedurave të realizuara.

Nga të dhënat e vitit 2023, rezulton që përdorimi i PNPNJK është aplikuar në veçanti nga Autoritetet Kontraktuese të nivelit jo-qeveritar (ndërmarrjet publike) të cilat kanë pjesëmarrjen më të madhe në totalin e vlerës dhe numrit të procedurave të realizuara nëpërmjet PNPNJK , apo me rreth 60% të vlerës totale. Në lidhje me këtë vlenë të theksohet që vetëm një kontratë e nënshkruar nëpërmjet PNPNJK arrinë vlerën prej 56,522,000.00 Euro (nga AK-KEK për arsye objektive dhe të

detyrueshme teknike) apo rreth 47% të totalit të procedurave të negociuara të zhvilluara nga të gjitha autoritetet kontraktuese.

Duhet theksuar që një pjesë e konsiderueshme e përdorimit të PNPNJK i janë referuar punëve shtesë apo punëve të paparashikuara të kontratave në implementim, por gjithashtu një numër i konsiderueshëm i referohet emergjencave ekstreme (në shumicën e rasteve si pasojë e dështimit të procedurave të rregullta të prokurimit) dhe për të cilat AK nuk kanë ofruar analizë dhe arsyetim bindës mbi arsyet e përdorimit të PNPNJK me referencë “emergjencë ekstreme”. Në shumicën e këtyre rasteve AK-se janë arsyetuar thjesht duke sqaruar se procedura e rregullt është në OShP apo në fazën e tenderimit duke mos dhënë edhe ndonjë informacion nëse lëshimet e AK në procedurën e hapur, mangësitë në DT (kritere kualifikuese kufizuese, etj) kanë bërë që procedura të përfundojë me ankesë nga OE dhe me këtë edhe të krijohen situata të emergjencës brenda AK.

Në grafikonin më poshtë janë paraqitur statistikatat mbi numrin e procedurave të negociuara të të realizuara gjatë vitit 2023 dhe viteve paraprake 2020, 2021 dhe 2022.



Grafiku 6

### Monitorimet sipas rastit

Monitorimet sipas rastit	
Përshkrimi i monitorimit	Raste
Rekomandime për përmirësimin e kërkesave	518
Opinione për përmirësimin e kërkesave	11
Përgjigje sipas kërkesës të OE apo palëve të interesuara	32
Raporte për qasje në dokumente publike	2
Kërkesa për sqarim	8
Opinione për PNPPNJK	23
Kërkesa për sqarim të PNPPNJK	4

Tabela 7



## Të arriturat e Departamentit të Monitorimit

Si të arritura të Departamentit të Monitorimit gjatë vitit 2023 evidentohet aplikimi i:

- Metodologjisë së Monitorimit sipas Listat harmonizuese/kontrolluese (për të gjitha procedurat)
- Veglës për komunikim me Autoritetet Kontraktuese;
- Veglës për menaxhimin e kontratave, dhe
- Funksionalizimi i Divizionit të Analizës dhe Statistikave.

## Funksionalizimi i Divizionit të Analizës dhe Statistikave

Divizioni për Analizë dhe Statistikë, funksionon në kuadër të Departamentit për Monitorim dhe Mbikëqyrje dhe kryen detyrat e përcaktuara duke u mbështetur në nenin 87 të Ligjit të Prokurimit Publik me nr. 04/L-042 dhe nenit 11 të Rregullores së Punës së Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Në gjysmën e dytë të vitit 2023 Divizioni për Analizë dhe Statistikë në kuadër të Departamentit të Monitorimit në KRPP ka rritur ndjeshëm aktivitetet e sajë në drejtim të funksionalizimit të këtij divizioni, ky aktivitet është përkrahur nga projekti USAID/KMI, përkrahje e cila solli ndryshime të konsiderueshme lidhur me analizimin e të dhënave në KRPP sidomos duke ditur kufizimet e konsiderueshme lidhur me analizimin e të dhënave me të cilin përballej KRPP.<sup>1</sup> Edhe pse të dhënat në KRPP ishin të bollshme, për shkak të mbledhjes së tyre përmes sistemit të prokurimit elektronik, në KRPP mungonte përdorimi i teknikave të analizës së të dhënave të përdorura zakonisht në prokurimin publik. Pengesat kryesore për funksionalizimin e divizionit të analizës së të dhënave ishin mungesa e ekspertizës dhe burimet e pamjaftueshme njerëzore për analizën e të dhënave.

Në përgjigje të këtyre sfidave, me përkrahjen e USAID u punua në funksionalizimin e Divizionit për Analizë dhe Statistikë në kuadër të Departamentit të Monitorimit në KRPP.<sup>2</sup> Përkrahja fillimisht është bërë me angazhimin e një eksperti për zhvillim të veglave/teknikave për grumbullim, përpunim dhe analizim të të dhënave të prokurimit në kohë reale dhe në mënyrë automatike, dhe më pas duke vazhduar me implementim të veglës dhe transferim të njohurive për përdorim të veglës tek divizioni i analizës dhe statistikave, në mënyrë që grumbullimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave të bëhet në mënyrë të pavarur në vitet në vijim.

Ndërsa në kuadër të bashkëpunimeve me institucionet e tjera gjatë vitit 2023 Departamenti i Monitorimit ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me institucionet tjera si: Agjencia Kundër Korrupsion, Agjensinë Qendrore të Prokurimit, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Njësitë për hetimin e Krimeve Ekonomike, Agjencia për Informim dhe Privatësi, Autoriteti i Konkurrencës, OJQ-të si dhe me palët tjera të interesuara, duke ofruar asistencë në sqarimin dhe zbatimin e ligjit të prokurimit publik.

---

<sup>1</sup> <https://www.facebook.com/profile.php?id=100089577137622> (11.08.2023, 30.11.2023)

<sup>2</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=616>

### 5.3 Aktivitetet e Departamentit të Trajnimeve dhe Integritimeve

Në mbështetje të Ligjin Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, konkretisht sipas nenit 25 të LPP-së, KRPP-ja duhet të ndikoj në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore në prokurim publik nëpërmjet organizimit të trajnimeve, poashtu sipas neni 87, paragrafi 2.17 i LPP-se, ka përgjegjësi për proceset e Integritimit Evropian në fushën e prokurimit publik si dhe të ndërveprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik.

Departamenti për Trajnim dhe Integritim, sfidat dhe problemet e sistemit të prokurimit publik në Kosovë ka synuar të adresoj përmes programeve trajnuese për prokurim, qëllimi i të cilave është që të ofrojë mbështetje dhe të bëjë më të lehtë punën e zyrtareve të prokurimit në zgjidhjen e problemeve ose gjetjen e zgjidhjeve në mënyrë më kreative dhe efikase brenda kornizës ligjore për prokurim. Departamenti për trajnime dhe integritime ka ndërvepruar, bashkëpunuar dhe raportuar për çështjet që lidhen me prokurimin publik në proceset e Integritimit Evropian. Në këtë kontest KRPP-ja në vazhdimësi ka mbajtur takime, ka raportuar dhe bashkëpunuar me Institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare sa i përket fushës së prokurimit publik, me Departamentet/Zyrat përkatëse për Integritim Evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM/DIE), MFPT, BE, OECD-SIGMA, Bankën Botërore dhe institucionet të tjera. Gjithashtu, gjatë vitit 2023, Departamenti për Trajnime dhe Integritim Evropian ka ndërvepruar dhe bashkëpunuar në ofrimin e të dhënave mbi zbatimin e Strategjisë për Reformën në Menaxhimin e Financave Publike (SRMFP, 2022-2026) dhe Planit të Veprimt (2022- 2026) për zbatimin e Strategjisë, pjesë e së cilës është edhe prokurimi publik. Vlen të theksohet se sipas Aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimt (2022-2024) të Strategjisë, në aktivitetet për vitin 2023, si:

1. Organizimi i katër punëtorive/trajnime mbi kriterin e çmimit/cilësisë (TEMF) për dhënie (janë mbajtur 6 dite trajnim);
2. Prezantimi i anketës(ave) të rregullta për përdoruesit e prokurimit publik dhe perceptimit publik në lidhje me prokurimin publik (pyetëtori për vlerësimin e trajnimeve në prokurim publik);
3. Zhvillimi i manualit mbi kriteret e çmimit/cilësisë (TEMF) për dhënie (Manuali i përgatitur dhe publikuar);
4. Zhvillimi i manualit për hulumtimin e tregut (Manuali i përgatitur dhe publikuar) si dhe
5. Mbajtja e takimeve koordinuese të institucioneve kyçe të koordinuara nga KRPP, janë aktivitete që janë realizuar nga Divizioni për IE, gjatë vitit 2023, në koordinim dhe mbështetje edhe nga projektet mbështetëse aktuale në fushën e prokurimit publik. Si rezultat, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe është finalizuar Protokollin e Bashkëpunimit, i cili përcakton qëllimin, parimet dhe objektivat e bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve kyçe relevante të prokurimit publik për adresimin efektiv të sfidave në fushën e prokurimit publik në Kosovë.

6. Është koordinuar procesi i organizimit të një vizite studimore në Kroaci, për 3 organet Qendrore të prokurimit publik në Kosovë (OSHP, KRPP, AQP). Si rezultat, në datat 04-08 dhjetor 2023, përfaqësues nga 3 institucionet relevante në fushën e prokurimit publik në Kosovë, ka pasur vizitë studimore në Republikën e Kroacisë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira nga institucionet relevante në fushën e prokurimit publik në Kroaci.<sup>3</sup>

Në funksion të objektivit Ngritje e kapaciteteve në prokurim publik nëpërmjet trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm, Departamenti i Trajnimeve dhe Integriteteve në KRPP për periudhën raportuese, ka planifikuar dhe realizuar këto aktivitete:

- *Vlerësimi i nevojave të AK-se dhe palëve të tjera për trajnim dhe certifikim në prokurim publik në pajtueshmëri me rregullat e reja për trajnime dhe kërkesave ligjore nën 25.i LPP*
- *Trajnime për Autoritete Kontraktuese në pajtueshmëri me ndryshimet ligjore – aprovimit të Ligjit të ri të PP;*
- *Trajnime të dedikuara për zyrtarë të Autoriteteve Kontraktuese për aplikimin e kriterit të dhënies TEMF/MEAT;*
- *Trajnime të zyrtarëve të Autoriteteve Kontraktuese për përdorim të moduleve të menaxhimit të kontratës dhe vlerësimit të performancës;*
- *Organizimi i trajnimeve të dedikuara për zyrtarët/auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përdorim të funksionaliteteve të prokurimit elektronik dhe aspektit ligjorë në prokurim publik;*
- *Organizimi i trajnimeve të dedikuara për zyrtarë të Policisë së Kosovës, në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik.*

### **Vlerësimi i nevojave të AK-se dhe palëve të tjera për trajnim dhe certifikim në prokurim publik në pajtueshmëri me rregullat e reja për trajnime dhe kërkesave ligjore nën 25.i LPP-së**

Vlerësimi i nevojave të Autoriteteve Kontraktuese për trajnim dhe certifikim në prokurim publik është proces i vazhdueshëm në KRPP. Ky aktivitet është burim apo rrjedhojë e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në Divizionin e Trajnimeve për vitin vijues. Duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e Autoriteteve Kontraktuese, anketes se realizuar mbështetur nga Ambasada e Anglisë, zbatimit të Marreveshjeve të Bashkëpunimit me institucionet relevante të Republikës së Kosovës, KRPP ka planifikuar dhe mbajtur trajnime për Autoritetet Kontraktuese mbi Menaxhimin e Kontrates, Tenderin Ekonomikisht më të Favorshëm (TEMF), Trajnime specifike për Zyren Kombëtare të Auditimit dhe Policinë e Kosovës, pastaj duke u bazuar në kërkesat e Komisionit Evropian janë mbajtur trajnim për Hulumtimin e tregut për tre institucionet kryesore të prokurimit publik.

---

<sup>3</sup>[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid029pCksNK23oX1SAVbLDGeYwKC94sw88TM3cfFzvxL8xX5dHeEW22Sand5v6mugwaCl&id=100089577137622](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid029pCksNK23oX1SAVbLDGeYwKC94sw88TM3cfFzvxL8xX5dHeEW22Sand5v6mugwaCl&id=100089577137622)

### **Trajnimet dhe certifikimet e nivelit themelor dhe te avancuar profesional në prokurim publik sipas kërkesave ligjore te nenit 25 te LPP-se**

Meqenëse në fund të vitit 2022 është mbajtur Trajnimi për nivelin themelor profesional për prokurim publik dhe numri i të certifikuarëve me certifikate te nivelit themelor profesional deri tani është 968, ky lloj trajnim nuk ka pas kërkesa te theksuara deri dy muaj para perfundimit te vitit 2023. Ndersa sipas kërkeses ligjore te nenit 25 te LPP se bashku me IKAP, është mbajtur trajnimi i avancuar profesional per prokurim publik për zyrtarët të cilët kane qene të pajisur me certifikatë themelore profesionale në prokurim publik me vlefshmëri 3 vjeçare (2021-2023). Të drejtë pjesëmarrje ne kete trajnim kishin 160 persona te pajisur me certifikate themelore profesionale, permes te cileve ju kerkua ta konfirmojne pjesemarrjen ne trajnim, nga të cilet 113 konfirmuan pjesemarrjen. Ne baze te vijimesise, 104 persona kane qene me te drejte pjesemarrje ne test ndersa 101 persona jane nenshtuar testit. Nga gjithsej 101 persona qe i jane nenshtuar testit 17 persona kane arritur te kalojne testin, keshtu duke e rritur numrin e pergjithshem te te certfikuarëve ne nivelin e avancuar profesional ne 594. Trajnerëve te cilët janë angazhuar ne mbajtjen e trajnimit, si dhe te gjithë pjesëmarrësve te cilët e kane vijuar trajnimin e nivelit te avancuar profesional për vitin 2023, iu është dërguar materiali i trajnimit me kohe. Gjate ketij procesi jane perfunduar te gjitha fazat e trajnimit dhe certifikimit duke filluar nga dergimi she shpallja e njoftimit per trajnim, perzgjedhja e trajnerëve, dergimi i moduleve dhe materialit, vijueshmeria e pjesemarrësve ne trajnim, testimi, vleresimi, shpallja e rezultateve, shqyrtimi i ankesave, rivleresimi i testeve, publikimi i rezultateve dhe ndarja e certifikatave.<sup>4</sup>

### **Trajnime për Autoritete Kontraktuese në pajtueshmëri me ndryshimet ligjore – aprovimit të Ligjit të ri të PP**

Ligji i Ri i Prokurimit Publik akoma nuk është aprovuar, KRPP, me qëllim te parapergatitjes dhe identifikimit te mangesive, sfidave si dhe mundësive te avancimit te mëtutjeshëm te sistemit te trajnimeve ne fushen e prokurimit publik, ne kuadër te projektit:” Asistencë Teknike për të mbështetur zbatimin e Reformave të Menaxhimit të Financave Publike në Kosovë”, qe financohet nga BE, dhe zbatohet përmes GIZ, ka angazhuar eksperte per analizimin e sistemit te trajnimit ne fushen e prokurimit publik. Kjo analize është pergatitur duke u bazuar ne takimet me personat korespondent ne KRPP, pastaj takime me disa Autoritete Kontraktuese, zhvillimin dhe dergimin e anketes per AK, konsultimin e Ligjit dhe Rregullores Aktuale per Prokurim Publik.

### **Trajnime të dedikuara per zyrtarë të Autoriteteve Kontraktuese për aplikimin e kriterit të dhënies TEMF/MEAT**

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve profesionale per aplikimin e kriterit Tenderi Ekonomikisht me i Favorshëm (TEMF) ne fushën e prokurimit publik, KRPP, duke u mbështetur nga projekti “KSV 019 Asistenca Teknike ne Kontekst të Integritimit Evropian”, qe zbatohet përmes Zyrës për Kriteria Ekonomike dhe Treg të Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, mbajti trajnim për përdorim te kriterit Tenderi Ekonomikisht me i Favorshëm (TEMF), për zyrtaret e Autoriteteve

---

<sup>4</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=473> (01.01.2023-31.12.2023)

Kontraktueses te ndare ne dy faza dhe gjashtë grupe. Pjesëmarrës në trajnime ishin 136 zyrtarë të 62 Autoriteteve Kontraktuese të nivelit qendror dhe lokal.<sup>5</sup> Ky aktivitet ka tejkaluar cakun e planifikuar të treguesitë numer tre me rradhë në planin e performances te vitit 2023.<sup>6</sup> Meqë përdorimi i kriterit TEMF ne prokurim publik, lejon kombinimin optimal midis kosos dhe elementeve cilësore të tenderit në mënyrë që të plotësohen më mirë nevojat e Autoriteteve Kontraktuese , KRPP, do te vazhdoje qe përmes trajnimeve ne lidhje me përdorimin e këtij kriteri te dhënies se kontratave ne prokurim publik, te forcoje kapacitetet profesionale te zyrtareve te prokurimit si dhe te inkurajoje Autoritetet Kontraktuese, ne përdorimin e këtij kriteri. Rritja e përdorimit te kriterit TEMF, gjate zhvillimit te aktiviteteve te prokurimit nga AK-se , është një kërkese e adresuar ne vijimësi ne raportet e progresit te KE për vendin, ne lidhje me prokurimin publik. Manuali i TEMF është publikuar nga KRPP dhe është një dokument ndihmës konsultues për AK-se, gjate zbatimit te aktiviteteve ne prokurim publik.<sup>7</sup>

### **Trajnimi i zyrtarëve te Autoriteteve Kontraktuese per përdorim te moduleve te menaxhimit te kontratës dhe vlerësimit te performances**

Me qellim te ngritjes dhe forcimit te kapaciteteve profesionale te zyrtareve pergjegjes te Autoriteteve Kontraktuese per menaxhimin e kontratave ne fushen e prokurimit publik, konform kerkesave te Autoriteteve Kontraktuese, KRPP ka mbajtur trajnime per përdorimin e moduleve për menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve përmes sistemit të e-prokurimit duke pershire edhe ceshtjet ligjore per gjithsej 23 Autoritete Kontraktuese dhe gjithsej per 426 zyrtare pjesemarres te ketyre autoriteteve per periudhen raportuese.<sup>8</sup>

Autoritet kontraktuese qe jane trajnuar gjate ketij viti, jane: Komuna Ferizaj, Kuvendi i Kosoves, Kuzhina Qendrore, SKGJK, KRM PASTRIMI, Zyra e Presidentes se Kosoves, N.H Iber-Lepenc, Inspektorati Policor i Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Kosoves, Agjencia Kosovare per Verifikim dhe Krahasim te Pronave, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Trafiku Urban SH.A,

Dogana e Kosoves, Ministria e Drejtësisë, MMPHI, Ministria e Drejtësisë - Agjensione në kuadër të MD-së, Telekom i Kosoves (Vala), UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI", KRU"Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren, Akademia e Drejtësisë, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës dhe Zyra e Kryeministrit.

Ne fund te cdo trajnimi pjesemarresit jane pajisur me certifikata të pjesëmarrjes. Permes ketij aktiviteti eshte tejkaluar caku i planifikuar të treguesi numer dy me rradhë në planin e performances te vitit 2023.<sup>9</sup> KRPP do te vazhdoj me kete aktivitet edhe vitin 2024, meqenese kerkesat e AK jane te vazhdueshme.

<sup>5</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=473> (31.05.2023, 27.06.2023)

<sup>6</sup> [https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Rreth%20Nesh/Objektivat/Plani%20i%20Performances%20KRPP\\_2023\\_shq.pdf](https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Rreth%20Nesh/Objektivat/Plani%20i%20Performances%20KRPP_2023_shq.pdf)

<sup>7</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Manuals/Narucitelji/DORACAK%20P%C3%8BR%20P%C3%8BRDORIMIN%20E%20KRITERIT%20TEMF.pdf>

<sup>8</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=473> (01.01.2023 – 31.12.2023)

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100089577137622> (01.01.2023 – 31.12.2023)

<sup>9</sup> [https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Rreth%20Nesh/Objektivat/Plani%20i%20Performances%20KRPP\\_2023\\_shq.pdf](https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Rreth%20Nesh/Objektivat/Plani%20i%20Performances%20KRPP_2023_shq.pdf)

### **Organizimi i trajnimeve të dedikuara për zyrtarët/auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përdorim të funksionaliteteve të prokurimit elektronik dhe aspektit ligjorë në prokurim publik**

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të ZKA dhe KRPP, poashtu zbatimit të objektivave të Planit të Performancës të vitit 2023, mbajti trajnim për rreth 120 zyrtarëve auditues të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Fokusi i trajnimit ishte përdorimi i sistemit elektronik të prokurimit dhe ndryshimet në rregulloren e re, me qëllim të ngritjes së kapacitetet profesionale të zyrtarëve auditues në përdorimin e platformës ‘e-prokurimi’ pas ndryshimeve në legjislacionin dytësor të prokurimit publik drejt identifikimit të gjetjeve dhe minimizimit të këtyre gjetjeve, sidomos në fushën e prokurimit publik, meqenëse prokurimi si fushë është mjaft komplekse dhe e ndjeshme. Në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit që e kanë përcjellë trajnimin (114 zyrtarë) janë pajisur me çertifikatën e pjesëmarrjes në trajnim të lëshuar nga KRPP.<sup>10</sup>

### **Organizimi i trajnimeve të dedikuara për zyrtarë të Policisë së Kosovës, në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik**

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të KRPP-se dhe Policisë së Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik mbajti trajnim për zyrtarë/hetues të Policisë së Kosovës. Trajnimi u mbajt në ambientet e Policisë së Kosovës dhe për fokus kishte trajnimin të dedikuar për zyrtarë policorë në përdorimin e funksioneve të sistemit të prokurimit elektronik me qëllim të përdorimit dhe hetimit të pavarur dhe në kohë reale të aktiviteteve të prokurimit<sup>11</sup>. Në këtë trajnim morën pjesë një grup prej 10 zyrtarë policorë, derisa trajnime të tilla do të vazhdojnë në varësi të kërkesave dhe nevojave të zyrtarëve të Policisë së Kosovës.

### **Organizimi i trajnimeve për Institucionet Qendrore të Prokurimit mbi Hulumtimin e Tregut**

Është koordinuar procesi si dhe është mbajtur punëtori për hulumtim paraprak të tregut në prokurim publik, për 22 pjesëmarrës nga tre Institucionet Qendrore të Prokurimit Publik në Kosovë si KRPP, OSHP dhe AQP. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte ngritja e kapaciteteve të stafit të këtyre Institucioneve, përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik në Kosovë në lidhje me analizën e tregut në prokurim publik dhe praktikën e mira të BE në këtë çështje. Udhëzuesi për analizë të tregut në prokurim publik, është publikuar nga KRPP dhe është një dokument ndihmës konsultues për AK-se, gjatë zbatimit të prokurimit publik për një hulumtim të mirëfillta paraprak të tregut, kërkesë kjo e theksuar në vijimësi në raportet e progresit të raportet e

---

<sup>10</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=473> (20.01.2023)

<sup>11</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=615>




progresit të KE për vendin.<sup>12</sup> Ky aktivitet është realizuar edhe pse nuk ka qene i listuar ne planin e performances te vitit 2023.

**Përmbledhje:** Duhet theksuar se të gjitha trajnimet e mbajtura gjatë vitit 2023, kanë ndikuar dukshëm në ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve të zyrtarëve të AK të Republikës së Kosovës në fushën e prokurimit publik, sidomos në rritjen e përdorimit të kriterit TEMF dhe përdorimit të modulit të menaxhimit të kontratave. Lidhur me organizimin e trajnimeve nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të autoriteteve kontraktuese për të përdorur raportin ndërmjet çmimit dhe cilësisë më të mirë si kriter për dhënien e kontratës dhe mbi përdorimin e moduleve për menaxhimin e kontratave dhe për vlerësimin e performancës së kontraktorëve *është cekur ne Raporti për Kosovën përparitur nga Komisionit Evropian për vitin 2023.*<sup>13</sup>

Sektorit të prokurimit publik gjatë vitit 2023 i janë shtuar edhe 17 zyrtarë të pajisur me certificate të avancuar profesionale në prokurim, duke ngritur numrin e përgjithshëm të zyrtarëve të çertifikuar me avancim në 594 te certifikuar.

Ndërsa, sipas planifikimeve dhe adresimit të kërkesave dhe nevojave të Autoriteteve Kontraktuese, gjatë vitit 2023 rreth 812 zyrtarë të Autoriteteve Kontraktuese kanë ndjekur ne pergjithesi te gjitha trajnimet e lartecekura nga departamenti i trajnimeve dhe intergrimeve ne KRPP.



Grafiku nr.1. Numri i zyrtarëve të trajnuar për vitin 2023, sipas kategorisë së trajnimit

<sup>12</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Lajmet%20levizese/alb/617/UDH%C3%8BZUES%20P%C3%8BR%20ANALIZ%C3%8BN%20E%20TREGUT.pdf>

<sup>13</sup> [https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report\\_SQ.pdf](https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf) (Kap.V, fq.76)

Pra, nga total 812 zyrtarë pjesëmarrës në trajnime, sipas kategorise së trajnimit, 104 janë pjesëmarrës të trajnuar në programin profesional të avancuar, 136 janë zyrtarë të trajnuar për kriterin TEMF, 426 zyrtarë janë të trajnuar për Menaxhim të Kontratave, 124 zyrtarë janë të trajnuar sipas Marreveshjeve të bashkëpunimit, 22 zyrtarë janë të trajnuar mbi Hulumtimin e tregut.

Çështja e rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve relevante kyçe në sistemin e prokurimit publik është trajtuar në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike, në pjesën e prokurimit publik. Si rezultat, janë duke u mbajtur takime të rregullta koordinuese të institucioneve kyçe në fushën e prokurimit publik, të koordinuara nga KRPP, me qëllim të shkëmbimit të informacionit, adresimit të çështjeve të identifikuara, identifikimit të aktiviteteve të përbashkëta vijuese, identifikimit të nevojave për trajnim, etj. Gjatë vitit 2023 janë mbajtur tre takime. Dy takime janë mbështetur nga partneret USAID përmes projektit Integriteti i Komunave të Kosovës dhe një takim është mbështetur nga partnerët, Zyra e Komisionit Evropian në Prishtinë përmes projektit mbështetës Asistenca Teknike e BE-së për Mbështetjen e Zbatimit të Reformave të Menaxhimit të Financave Publike në Kosovë dhe Organizates relevante siç është SIGMA/OECD si një kontribues i rëndësishëm në fushën e prokurimit publik edhe në Kosovë. KRPP ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucionet tjera relevante në fushën e prokurimit publik. Si rezultat, është finalizuar Protokollin e Bashkëpunimit, i cili përcakton qëllimin, parimet dhe objektivat e bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve kyçe relevante të prokurimit publik për adresimin efektiv të sfidave në fushën e prokurimit publik në Kosovë.

Shumica e aktiviteteve të realizuara janë publikuar në linkun e-prokurimi dhe rrjetin social të KRPP-së në Facebook.



#### 5.4 Aktivitetet e Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik

Aktivitetet e Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik në kuadër të KRPP-së edhe gjatë vitit 2023 si qëllim dhe objektiv kryesorë kanë patur mbajtjen e sistemit të prokurimit elektronik plotësisht të operueshëm dhe funksional në mënyrë që të gjitha aktivitetet e prokurimit nga Autoritetet Kontraktuese të realizohen në mënyrë sa më efektive dhe efikase.

Në këtë pjesë të raportit, përveç aktiviteteve të Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik të cilat kanë për qëllim operimin dhe funksionimin e pandërprerë të sistemit të prokurimit elektronik dhe përmbushjen e objektivave të planifikuar në planin e performancës së KRPP-së, do të paraqiten edhe të dhëna statistikore të cilat janë pjesë e sistemit.

Ndër aktivitetet kryesore të departamentit të sistemit të prokurimit elektronik, veçojmë:

- Administrimin e përditshëm të infrastrukturës harduerike dhe softuerike të sistemit të prokurimit elektronik, parandalimin, evitimin dhe zgjidhjen e problemeve për të siguruar qëndrueshmëri dhe operim të pandërprerë të Sistemit të Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës
- Ofrim të shërbimeve në dhënie të ndihmës teknike dhe instruksioneve nëpërmjet tavolinës ndihmëse (linjë telefonike, postë elektronike dhe prezencë fizike) për të gjithë përdoruesit e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik gjatë përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik
- Aplikimin e procedurave standarde të TI-së në ruajtje dhe arkivim në bazë ditore të të dhënave të sistemit të prokurimit elektronik
- Dhënie e ndihmës teknike dhe mbështetjes për të gjithë stafin e KRPP-së, departamentin e rregullave, monitorimit dhe trajnimeve, në funksion të rritjes së njohurive në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik dhe transformimit nga prokurimi tradicional në atë elektronik
- Bashkëpunim dhe koordinim me institucionet e Ministrisë së Punëve të Brendshme/Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrisë së Financave, si institucione të përfshira në mënyrë direkte dhe indirekte në operim të sistemit të prokurimit elektronik
- Pasurim i portalit <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, me informacione, pyetje të shpeshta, njoftime dhe vendime të përgatitura nga KRPP dhe publikuar për publikun e gjerë
- Avancimi i platformes së prokurimit elektronik me funksionet e reja lidhur me sistemin e ankimit apo me operimin me "Kërkesat për rishqyrtim" dhe "Ankesat" - të cilat funksione të reja janë vënë në funksion nga data 24.01.2023.
- Përgaditja dhe publikimi i "Manualeve për përdoruesit" për Operatorë Ekonomik dhe Autoritete Kontraktuese lidhur me funksionalitetet e reja "Kërkesat për rishqyrtim" dhe "Ankesat".
- Realizimi i procesit të auditimit të teknologjisë së informacionit "Sistemi elektronik E-prokurimi", proces i cili është realizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit në periudhën maj-


qershor 2023 dhe i cili ka rezultuar me një raport auditimi mbi analizën, të gjeturat dhe rekomandimet. Objektiv i procesit të auditimit ka qenë vlerësimi nëse KRPP-ja ka menaxhuar me efektivitet operacionet e TI-së, që të sigurohet se sistemi elektronik “E-Prokurimi” mbështet në vazhdimësi procesin e prokurimit publik si dhe ruan integritetin e tij.

- Përgaditja e Planit të Veprimit për adresim të të gjeturave dhe rekomandimeve nga raporti i auditimit të realizuar nga ZKA
- Përmbyllja e kontraktimit për projektin “ Ndërlidhja/ndërvepueshmëria e sistemit të Prokurimit elektronik me Sistemin e Thesarit”. Kontraktimi është bërë me datë 15.11.2023 në vlerë 71,980.00 €
- Mirëmbajtja dhe avancim i web aplikacionit për publikim të të dhënave sipas standardit për të dhëna të hapura, publikimi i ndryshimeve në web-aplikacion dhe dhenia e instruksioneve për përdorim nga të gjitha palët e interesuara në <https://ocdskrpp.rks-gov.net/Help>.
- Mirëmbajtja dhe administrimi i veglës për monitorim të aktiviteteve të prokurimit nga ana e zyrtarëve të monitorimit të KRPP-së, monitorim i bazuar në indikatorë të përzgjedhur.
- Zhvillimi dhe publikimi i web faqes së re të KRPP-së ( versioni fillestar) <https://krpp.rks-gov.net>,


**Të dhëna statistikore:** Nga të dhënat statistikore aktuale për periudhën raportuese listojmë:

- Të gjitha ofertat në aktivitete të prokurimit janë përgaditur dhe dorëzuar nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik gjatë vitit 2023– rreth **27,800** oferta në të gjitha procedurat.
- Janë (**214**) AK të regjistruara dhe aktive në platformën e prokurimit elektronik me rreth **18,800** përdorues
- Ka arritur në rreth **16,400** numri i OE të regjistruar të cilët përdorin platformën në mënyrë aktive
- Numri i të gjithë përdoruesve të regjistruar ka arritur në rreth **44,300** ( përfshirë personat fizik)
- **28,744** publikime të të gjitha llojeve ( në 2023) nga **152,000** publikime që deri më tani janë pjesë e platformës;
- **12,397** procedura të prokurimit janë zhvilluar ( përgaditur dhe publikuar), nga të cilat rreth **10,183** kanë përfunduar me njoftim për nënshkrim kontrate.

Më poshtë janë paraqitur disa të dhëna statistikore mbi numrin e përdoruesve, AK-se dhe OE aktual dhe aktiv në sistem të prokurimit elektronik



Grafiku 7



Grafiku 8

### 5.5 Aktivitetet e bashkëpunimit dhe përkrahjes nga donatorët

Për periudhën raportuese KRPP ka vazhduar aktivitetet e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare nga të cilat ka përfituar përkrahje nëpërmjet projekteve të financuara nga institucionet respektive, si: USAID, EU, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar (UK), Qeveria e Luksemburgut, etj.

Edhe gjatë vitit 2023 bashkëpunimi dhe përkrahja nga donatorët ka qenë kryesisht në ofrimin e asistencës dhe shërbimeve të konsulencës dhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale të KRPP-se.

**Përkrahja nga USAID:** Gjatë vitit 2023 USAID nëpërmjet projektit të KMI-së ( Kosovo Municipality Integrity) të implementuar nga DAI ka vazhduar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve për t'u përkrahur në KRPP.

Bashkëpunim dhe përkrahja nga projekti KMI gjatë vitit 2023 ka vazhduar në pajtueshmëri me Memorandumin e Mirëkuptimit ( të arritur në vitin 2022), me fokus të veçantë në ngritjen e kapaciteteve në fushën e monitorimit dhe përpunimit dhe analizimit të të dhënave të prokurimit publik. Në funksion të ngritjes së ketyre kapaciteteve, projekti KMI ka mbështetur KRPP-në me dy ekspert, një në fushën e prokurimit të ndërlidhur me ri-dizajnimin dhe aplikimin e listës kontrolluese për aktivitetet e monitorimit nga ana e zyrtarëve të monitorimit dhe një ekspert në fushën e analizës së të dhënave. Nga kjo mbështetje, gjatë vitit 2023 është arritur që aktivitetet e monitorimit nga zyrtarët e departamentit të monitorimit në KRPP, të monitorohen bazuar në një metodologji krejtësisht të re nga ajo paraprake, dhe gjithashtu është arritur që të funksionalizohet divizioni i analizeës brenda departamentit të monitorimit. Vlenë të theksohet që me funksionalizimin e divizionit të analizës dhe zhvillimit/implementimit të veglës për përpunim të të dhënave në formë analitike, KRPP do të ketë në dispozicion të dhëna të sakta në kohë reale dhe të mbështetur në një numër të konsiderueshëm të indikatorëve.

Duhet theksuar që përveç përkrahjes direkte të KRPP-së, projekti KMI/USAID edhe gjatë vitit 2023 ka vazhduar përkrahjen e Autoriteteve Kontraktuese të nivelit lokal dhe qëndror me ekspertizë në fushën e prokurimit, menaxhimit të kontratave, buxhetit, etj, në mënyrë që të ngritet niveli i integritetit dhe llogaridhënies në institucionet komunale dhe qëndrore gjithashtu.

**Përkrahja nga EU:** Edhe gjatë vitit 2023 EU nëpërmjet projektit për ndihmë teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë (të implementuar nga GIZ), ka vazhduar ofrimin e përkrahjes së asistencës teknike dhe ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit publik. Duhet theksuar që përkrahja e projektuar nga ky projekt për vitin 2023 ( përkrahja në legjislacion primarë dhe sidomos në legjislacion dytësorë) nuk ka ndodhur në mungesë të miratimit të ligjit të ri për prokurimin publik. Nga përkrahja në ngritje të kapaciteteve duhet veçuar organizimin vizites studimore ne Republikën e Kroacisë, me përfaqësues nga 3(tre) institucionet qendrore te prokurimit publik (KRPP, OSHP dhe AQP), me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira nga institucionet relevante në fushën e prokurimit publik ne Kroaci. Nga projekti i EU-së ka patur gjithashtu edhe mbeshtetje per takimet nderinstitucionale dhe analizen e sistemit te trajnimit ne fushen e prokurimit publik.

**Përkrahja nga Qeveria e Luksemburgut (KSV 019):** Për periudhën raportuese edhe më tej KRPP ka patur mbështetjen nga Projekti Asistenca teknike në kontekst të integritimit evropian i zbatuar nga Zyra për Krite Ekonomike/Zyra e Kryeministrit dhe financuar nga Qeveria e Luksemburgut (KSV 019), që për qëllim ka zhvillimin e kapaciteteve institucionale në administratën publike të Kosovës në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA. Në kuadër të këtij projekti janë mbajtur trajnime për përdorim të kriterit të dhënies “ Oferta ekonomikisht më e favorshme” dhe është përgaditur Udhezuesi për Hulumtim të tregut në Prokurim Publik.

**Përkrahja nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar:** Gjatë periudhës raportuese projekti i mbështetur nga Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar (UK) ka vazhduar në përkrahjen e sektorit të prokurimit publik në fushën e ankesave apo sistemit të menaxhimit të lëndëve ( ankesave) dhe gjithashtu në përgaditjen dhe realizimin e pyetësorit për AK-se dhe OE në fushën e prokurimit.

## 6. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KRPP-së

Sipas Nenit 87.2.13, të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042, KRPP-ja së bashku me raportin vjetor në Qeveri dhe Kuvend duhet të dorëzojë edhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji.

Sikurse viteve paraprake edhe me teje mbetet ne proces qe Qeveria e Kosovës përkatësisht KRPP si Institucion i autorizuar për fushën legjislative në Prokurimin Publik të ketë si objektiv dhe synim kryesorë reformat edhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, me qëllim të ngritjes së transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies nga të gjithë aktorët të cilët janë të përfshirë në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit publik.

Edhe gjatë vitit 2023 përveç ndryshimeve/përditësimeve në legjislacionin dytësor që ka bërë KRPP ( Udhezuesit Nr-001/2023 per prokurimin publik dhe Manualet për Hulumtim të Tregut dhe Përdorimin e kriterit të dhënies TEMF), reforma kryesore në fushën legjislative apo aprovimi i Ligjit të ri të Prokurimit Publik nuk ka shënuar progres. Edhe gjatë vitit 2023 aprovimi i Ligjit të ri për Prokurimin Publik ka mbetur ende në fazën finale të draftimit. Prandaj, edhe më tutje një nga synimet dhe rekomandimet kryesore gjatë vitit vijues mbetet miratimi i ligjit të ri të LPP në mënyrë që legjislacioni në prokurimin publik të jetë i:

- (i) harmonizuar me Direktivat e reja të BE-së;
- (ii) harmonizuar plotësisht me legjislacionin për përdorim të mjeteve elektronike në prokurim, dhe
- (iii) aplikueshëm për eliminimin e dobësive të identifikuara gjatë zbatimit praktik të ligjit aktual

Sikurse në vitin paraprak rekomandimi për aprovim dhe vënies në fuqi të ligjit te ri të LPP-së përfshinë edhe një seri të rekomandimeve mbi fazat e mëtutjeshme të reformës të cilat duhet patur parasyshë para dhe pas aprovimit të Ligjit të ri të LPP.

Kryesisht, rekomandimet kanë të bëjnë me domosdoshmërinë që ndryshimet në legjislacionin primarë më tej do duhet të përcillen me ndryshimet në legjislacionin dytësor, të cilat KRPP duhet t'i bëjë në mbështetje të autorizimeve të veta dhe për të cilat ndryshime duhet të parashikohet dhe planifikohet një periudhë kohore si fazë kalimtare para fillimit të implementimit të ndryshimeve ligjore, dhe bazuar në kapacitetet aktuale të KRPP-së dhe domosdoshmërinë që ndryshimet ligjore të përshtaten plotësisht me mjetet elektronike ( prokurimin elektronik), atëherë rekomandohet që kjo fazë kalimtare të jetë së paku në një kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

Mbështetur në arsyet e cekura shkurtimisht më lartë por edhe në shumë dimensione tjera, në të cilat ndryshimet ligjore do të kenë efekte e të cilat nuk është arritur të prezantohen në këtë raport, KRPP i rekomandon Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që të përkrahin këtë reformë ligjore, derisa KRPP me departamentet përkatëse shprehë gatishmërinë për të qenë plotësisht në funksion të detyrimeve ligjore në implementim të kësaj reforme në prokurim publik dhe për të ofruar çfaredo sqarimi për të gjitha palët e interesit lidhur me kete proces tejet te rëndësishëm per vendin.

Krahas rekomandimeve që kanë për synim ndryshimet ligjore, duhet evidentuar edhe rekomandimet për eliminim të dobësive të identifikuara gjatë zbatimit praktik të ligjit aktual të cilat janë reflektuar edhe në të dhënat statistikore të aktiviteteve të KRPP-së dhe kontratave të nënshkruar nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese të paraqitura në këtë raport. Një ndër rekomandimet që duhet theksuar ka të bëjë me fuqizimin e aktiviteteve të monitorimit, sidomos me aplikimin e metodologjisë së re për monitorim e cila është e bazuar në lista kontrolluese dhe harmonizuese gjatë procesit të monitorimit të aktiviteteve të prokurimit. Me fuqizim të aplikimit të kësaj metodologjie synohet që të përmirësohet cilësia e monitorimit të aktiviteteve të prokurimit, përmirësim i cili në mënyrë direkte do të ndikoj në uljen e parregullësive në zhvillim të procedurave të prokurimit dhe me këtë edhe rritjen e efikasitetit në prokurimin publik.

Fokus të veçantë për KRPP-në edhe më tutje do të jetë adresimi i dobësive të identifikuara gjatë vitit 2023, dobësi të identifikuara gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit (të cilat janë specifikuar edhe në raportin e vitit paraprak) dhe sidomos gjatë fazes së implementimit të kontratave apo administrimit të implementimit të kontratave nga ana e autoriteteve kontraktuese.

Për të adresuar në mënyrë efektive dobësitë e identifikuara gjatë vitit 2023 dhe viteve paraprake, për KRPP-në edhe më tutje mbetet prioritet rekomandimi për ngritje dhe fuqizim të kapaciteteve me ekspertë të profesionalizuar në fushën e rregullave, monitorimit, teknologjisë informative, trajnimeve apo të gjitha departamenteve përkatëse të KRPP.

**Sfidat:** Mungesa e kapaciteteve të brendshme të mjaftueshme dhe të profesionalizuar në fushëveprimin që mbulojnë, mbetet një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet KRPP në vazhdimësi.

Gjatë vitit 2023 KRPP nuk ka arritur pothuajse fare të përmirësojë kapacitetet e brendshme të domosdoshme që sigurojnë përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësive që mbulon KRPP. Kjo për pasojë të dështimit të disa nga procedurave të rekrutimit dhe largimit të stafit në vazhdimësi, sidomos të stafit të TI-së.

Krahas përgjegjësive në aspektin ligjor, të monitorimit dhe trajnimeve në fushën e prokurimit publik, përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive në fushën e sistemit të prokurimit elektronik (si sistem i rëndësishëm dhe ndjeshmërisë së veçantë, me përdorim të gjerë në nivel qeveritarë dhe që kërkon administrim për një disponueshmëri dhe siguri të lartë), mbetet një nga prioritetet dhe sfidat kryesore të KRPP-së.

Duhet theksuar që kjo sfidë do të jetë edhe më e evidente në vijim, meqenëse për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik numri i pozitave të kategorizuara dhe kategorizimi i pozitave të TI-së nuk është bërë në pajtueshmëri me shtojcën 14.4 të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) nr. 11/2023 për ekspertët nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, edhe përkundër faktit që sistemi i prokurimit elektronik është kualifikuar si pjesë e infrastrukturës kritike shtetërore. Gjithashtu edhe këtë vit duhet ri-përsëritur që dinamika e proceseve dhe zhvillimeve në sektorin e



prokurimit publik që pritet të ndodhin gjatë vitit 2024 (sidomos miratimi i Ligjit të ri të Prokurimit Publik dhe obligimet dhe përgjegjësitë që burojnë nga ky ligj për KRPP-në), mungesa e kapaciteteve/burimeve njerëzore do të jetë sfida kryesore për KRPP-në.

Në këtë mënyrë KRPP edhe në këtë raportim rekomandon që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës t'i përgjigjet pozitivisht kërkesave buxhetore të KRPP-së që kanë të bëjnë me aprovimin e Ligjit të ri të Prokurimit Publik dhe aktivitetet që sigurojnë qëndrueshmëri, disponueshmëri dhe operim të pandërprerë të sistemit të prokurimit elektronik, sidomos në kërkesat që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore (ekspertëve të TI-së dhe ekspertëve të prokurimit) brenda KRPP-së në mënyrë që KRPP çdo herë dhe në çdo situatë të jetë e gatshme në përmbushjen mandatit si ofrues i shërbimeve për prokurim elektronik.

## 7. RAPORTI VJETOR FINANCIAR

### DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere**

Nga: **Osman Vishaj, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

**Albenita Berisha, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2023.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 të institucionit **Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik**.

**Data: \_\_ / 03 / 2024**

**(Nënshkrimi i ZKA)**

**Datë: \_\_ / 03 / 2024**

**(Nënshkrimi i ZKF)**

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

<b>Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për KRPP</b>				
<b>Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023</b>				
		<b>2023</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
		<b>Llogaria e vetme e Thesarit</b>	<b>Llogaria e vetme e Thesarit</b>	<b>Llogaria e vetme e Thesarit</b>
	<u>Shënim</u>	<b>BKK</b>	<b>BKK</b>	<b>BKK</b>
		<b>'000</b>	<b>'000</b>	<b>'000</b>
<b>BURIMET E FONDEVE -PRANIMET</b>				
Granti qeveritar		586.00	507.00	589.00
Të hyrat vetanake				
Të hyrat e dedikuara				
Të hyrat nga AKP				
Grantet e përcaktuara të donatorëve				
Klauzola e investimeve				
Fondi zhvillimor në mirëbesim				
Pranimet tjera				
<b>Gjithsej</b>		<b>586.00</b>	<b>507.00</b>	<b>589.00</b>
<b>SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT</b>				
Operacionet				
Paga dhe rroga	2	337.00	316.00	304.00
Mallra dhe shërbime	3	247.00	189.00	230.00
Shpenzime komunale	4	2.00	2.00	2.00
		<b>586.00</b>	<b>507.00</b>	<b>536.00</b>
Transferet				
Transfere dhe subvencione	5			
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6			53.00
Pagesa tjera	7			
<b>Gjithsej</b>		<b>586.00</b>	<b>507.00</b>	<b>589.00</b>

*Shënim:* Nga pasqyra e mësipërme vërehet që totali i pranimeve dhe pagesave në para të gatshme është nga Granti Qeveritar në vlerë prej 585,687€

**Neni 14**

**Raporti i ekzekutimit te buxhetit**

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për KRPP  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

		2023				2022	2021
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Varianca	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	F
		€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
<u>Shënime</u>							
<b>HYRJA E PARASË SË GATSHME</b>							
	Të hyrat tatimore				#DIV/0!		
	Të hyrat jo tatimore				#DIV/0!		
	Të hyrat e dedikuara				#DIV/0!		
	Grantet e përcaktuara të donatorëve				#DIV/0!		
	Tjera				#DIV/0!		
<b>Gjithsej Pranimet</b>		-	-	-	#DIV/0!	-	-
<b>DALJA E PARASË SË GATSHME</b>					#DIV/0!		
	Paga dhe rroga	337	337	362	100.00%	316	304
	Mallra dhe shërbime	247	299	299	82.61%	189	230
	Shpenzime komunale	2	5	5	40.00%	2	2
	Transfere dhe subvencione				#DIV/0!		
	Shpenzime kapitale		75	200	0.00%		53
	Tjerat				#DIV/0!		
<b>Gjithsej pagesat</b>		<b>586</b>	<b>716</b>	<b>866</b>	<b>#DIV/0!</b>	<b>507</b>	<b>589</b>

Sipas ligjit nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, buxheti fillestar i KRPP-së është: 866,200€.

Buxheti final në SIMFK është 716,807€, sipas kategorive ekonomike: Paga dhe shtesa 337,554€, mallra dhe shërbime 299,253€, shpenzime komunale 5,000€ dhe shpenzime kapitale 75.000€.

Buxheti i shpenzuar në fund të vitit 2023 është në vlerë prej 585,687€ sipas kategorive ekonomike: paga dhe shtesa 337,554€, mallra dhe shërbime 246,874€, shpenzime komunale 1,259€ dhe shpenzime kapitale 0.00€.

Niveli i ekzekutimit të buxhetit të KRPP-së për vitin 2023 është 81,70% krahasuar me buxhetin final

## **Neni 15**

### **Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare**

#### **Shënimi 1**

##### **1. Politikat kontabël**

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

##### **1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)**

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) është themeluar në bazë të Pjesës VI të Ligjit Nr. 04/L-042 për prokurim Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr.

05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Sipas nenit 86 të këtij ligji, KRPP-ja është agjenci e pavarur, rregullative dhe sipas nenit 87 të këtij ligji është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që jepen nga ky ligj.

Misioni i KRPP-së është zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e përgjithshme e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e sistemit elektronik të prokurimit publik në Kosovë (E-Prokurimi).

Si rrjedhojë, misioni i KRPP-së është të nxis respektimin e parimeve themelore të prokurimit lidhur me transparencën, llogaridhënien, konkurrencën e ndershme, trajtim të barabartë dhe vlerën për para duke përmirësuar kapacitetin e sistemit të prokurimit përmes:

- Avancimit të sistemit të monitorimit për zbatimin e kornizës ligjore të prokurimit publik,
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, trajnimi dhe arsimi,
- Avancimi i procedurave të menaxhimit të prokurimit publik,
- Rrjedhë më të mirë të komunikimit në mes të të gjithë aktereve të prokurimit publik,
- Prezanitmin e objektivave socio-ekonomike dhe mjedisore, në kuadër të politikave të gjelbra dhe të përgjithshme shoqërore të prokurimit publik, shfrytëzimin e metodave të reja bashkëkohore në zbatimin e ligjit të prokurimit publik si: prokurimit elektronik dhe prokurimi i centralizuar, si dhe
- Ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për funksionimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

KRPP-ja ka si qëllim kryesor garantimin e mirëfunksionimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, duke u fokusuar në aktivitetet dhe veprimtarinë e saj si në vijim:

- Përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor,
- Monitorimin e vazhdueshëm të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktuese,
- Përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit Elektronik të Prokurimit,
- Ngritja e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit në Autoriteteve Kontraktore,
- Dhënia e asistencës së vazhdueshme për Autoritetet Kontraktore,
- Rritja e efikasitetit të prokurimit publik.

## **1.2 Pagesat nga palët e treta**

Për vitin fiskal 2023 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nuk ka pasur pagesa nga palët e treta.

## **1.3 Shumat raportuese**

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

## **1.4 Valuta raportuese**

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

## **1.5 Data e autorizimit**

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesore Administrativë dhe Zv. Zyrtarja Kryesore Financiare.



**Neni 14.6**  
**Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit**

**Ndryshimet e autorizuara nga LMFP**

Kategoria e ndarjes	Buxheti Fillestar	Ndryshimi	Ndryshimi	Ndryshimi	Ndryshimi	Të hyrat	Grantet e percaktuara	Burime tjera te	Buxheti
	(Ligji i Buxhetit)	I	II	III	IV	vetanake	te donetoreve	financimit	përfundimtar
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	SIMFK
									€ '000
<b>Hyrjet</b>									
Të hyrat tatimore									-
Të hyrat jo tatimore									-
Të hyrat e dedikuara									-
Grantet e percaktuara të donatorëve									-
Huamarrjet									-
Tjera									-
<b>Gjithsej</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Daljet</b>									
Paga dhe rroga	362		(25)						337
Mallra dhe shërbime	299								299
Shpenzime komunale	5								5
Transfere dhe subvencione									-
Shpenzime kapitale	200		(125)						75
Kthimi i huamarrjeve									-
Tjerat									-
<b>Gjithsej</b>	<b>866</b>	<b>0</b>	<b>(150)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>716</b>

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Nga tabela e më sipërme më saktësisht neni 14.6 shihet harmonizimi i ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit për vitin 2023. Gjatë periudhës raportuese me vendim të qeverisë kemi deklaruar kursime në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 125,000€.

### Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin material në kolonën D (neni 14) , domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë se gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkoen ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës së ndryshimit.

### Shënimi 2 Paga dhe roga

Përshkrimi	2023									Krahasim %	2022 € '000	2021 € '000
	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	TH-AKP € '000	GPD € '000	K I € '000	FZHM € '000	Buxheti Final € '000			
Pagat neto përmes listës së pagave	283	283							337		267	257
Pagesa per sindikatë	-											
Pagesa neto për punë jashtë orarit	-											
Puntëtorët me kontratë (jo në listen e pagave)	-											
Tatimi ndaluar në të ardhura personale	22	22									19	18
Kontributi pensional-punetori	16	16									15	15
Kontributi pensional-punëdhënësi	16	16									15	15
<b>Paga dhe roga</b>	<b>337</b>	<b>337</b>	-	-	-	-	-	-	<b>337</b>	<b>100%</b>	<b>316</b>	<b>305</b>

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë: Buxheti final i KRPP-së për paga në vitin 2023 është 361,947€ i cili është shpenzuar në vlerë prej 337,552€ apo 100% e buxhetit final.

**Shënimi 3 Mallra dhe shërbime**

Përshkrimi	2023								Buxheti Final € '000	Krahasim %	2022 € '000
	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	TH-AKP € '000	GPD € '000	K I € '000	FZHM € '000			
	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-									
Meditjet për udhëtime zyrtre brenda vendit	-										
Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-										
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtre brenda vendit	-										
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	5	5								1	
Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	1	1									
Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	2	2									
Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	1	1									
Shpenzimet per internet	-										
Shpenzimet e telefonisë mobile	11	11								10	
Shpenzimet postare	-										
Shpenzimet për përdorimin e kabllit optik	-										
Shërbimet e arsimit trajnimit	-										
Shërbimet e përfaqësimit avokatë dhe ekspertë	-										
Shërbime të ndryshme shëndetsore	-										
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	36	36								40	
Sherbime shtypje-jo marketing	-										
Sherbime kontraktuese tjera	3	3								3	
Sherbime teknike	-										
Shpenzimet per anetaresim	-										
Sherbimet e varrimit	-										
Mobilje (me pak se 1000 euro)	-									3	
Paisje tjera me pak se 1000euro	14	14								2	
Furnizim per zyre	1	1								6	
Karburant per vetura	5	5									
Telefona (me pak se 1000 euro)	-										
Mirembajtja dhe riparimi I automjeteve	-									2	
Kompjuterë me pak se 1000 euro	-									3	

**Shpalos në detaje shënimet në tabelë:** Buxheti final për kategorinë e mallra dhe shërbime për vitin 2023 është në vlerë prej 299,253€, ndërsa realizimi është në vlerë prej 246,874€.

**Shënimi 4 Shpenzime komunale**

Përshkrimi	2023									Krahasim %	2022 € '000	2021 € '000
	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	TH-AKP € '000	GPD € '000	KI € '000	FZHM € '000	Buxheti Final € '000			
Rryma	-											
Uji	-											
Mbeturinat	-											
Ngrohja Qendrore	-											
Shpenzimet telefonike	2	2							5		2	2
Pagesa-vendimet gjyqësore	-											
<b>Shpenzime komunale</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	-	-	-	-	-	-	<b>5</b>	<b>40%</b>	<b>2</b>	<b>2</b>

Buxheti final për shpenzime komunale është 5,000€, ndërsa realizimi është në vlerë prej 1,259€.

